

Enkelejda Basha

Gerda Sula

LIBËR PËR MËSUESIN
Qytetaria 3

BOTIME



Përmbajtje

Çfarë na udhëzon programi i lëndës “QYTETARIA 3”	5
Hyrje në programin e qytetarisë	6
Programi i lëndës	15
Planifikimi mësimor vjetor dhe tremujor	21
Modele ditësh	29

Çfarë na udhëzon programi i lëndës “QYTETARIA 3”

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi/ja:

- Kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet, për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje e

globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxitin zhvillimin intelektual të nxënësit, duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilët nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme, e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve Qytetari (Njohuri për shoqërinë - klasa K-2), Histori, Gjeografi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve; Njohuri për shoqërinë, Qytetari, Gjeografi dhe Histori janë ngushtësisht të lidhura nga kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni, në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave

kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

1.1 Hyrje në programin e qytetarisë

Qytetaria demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ajo lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si e tillë, ajo përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- **Përmasën politike**, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.
- **Përmasën ligjore**, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve.
- **Përmasën kulturore**, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.
- **Përmasën shoqërore dhe ekonomike**, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.
- **Përmasa evropiane**, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.
- **Përmasën globale**, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe solidaritetit global.

Programi lëndor rrjedh nga Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave të qytetarisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Programi i lëndës Qytetari (Njohuri për shoqërinë në klasën K-2) në arsimin bazë është hartuar me një strukturë dhe mënyrë të re konceptimi, në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për ndërtimin e kompetencave kyçe të të nxënësve gjatë gjithë jetës në fushën e qytetarisë demokratike. Kompetencat e synuara në këtë program lidhen me kompetencat e tjera kyçe. Lidhja mes rezultateve të të nxënësve të kompetencave të lëndës së qytetarisë dhe, kur është e mundur, të kompetencave të tjera kyçe, siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Procesi i të nxënësve në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus të veçantë zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare.

- Kompetencat zhvillohen përmes tematikave të përbashkëta të fushës dhe në program zërthehen në njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishëm të programit të lëndës së qytetarisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Programi i qytetarisë për këtë shkallë të kurrikulës është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme, të shprehur në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxëniet të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave, ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxëniet për tematikë, duke qenë pjesë integrale e tyre.

- Strukturimi dhe organizimi i programit për shkallë kurrikule synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.

- Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxëniet për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e situatave të të nxëniet dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxëniet janë situata që lidhen me kontekstin e të nxëniet. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëniet, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.

- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj.

Programi i lëndës së Qytetarisë krijon mundësi integrimi brenda fushës dhe me fushat e tjera, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhën, artet, etj. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxëniet dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij, me jetën e përditshme.

- Programi sugjeron metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxëniet të tyre.

- Vlerësimi si pjesë integrale e procesit të të nxëniet, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

2.1. Qëllimet e programit të lëndës së qytetarisë


Edukimi për qytetari demokratike **synon**:

- Të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehi demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i lëndës së qytetarisë **synon**:

- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japë nxënësve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japë nxënësve mundësinë të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



2.2. Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen me kompetencave e tjera kyçe. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies.

Kompetenca qytetare

Programi i qytetarisë, si pjesë e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënies të synuara nga programi i lëndës së qytetarisë nxitin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i qytetarisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi

përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënësit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj, nxënësi zhvillon shkathtësitë të të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bëhen në terren. Programi i *qytetarisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënësit

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i *qytetarisë* nxit të nxënësit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tyre në procesin e të nxënësit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

Diagrami 2: Rezultatet e të nxënimit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si reference gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese*)

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie.
- Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).
- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënimit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë njëtemë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyrë/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

- Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

- Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distance për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti, duke I përmbledhur në një tabelë ose grafik).

2.3. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësisë qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

2.4. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësive qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë njerëzore. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

2.4. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Lënda e qytetarisë (Njohuri për shoqërinë klasa K-2) duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mire çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Historia dhe qytetaria

Lënda e historisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
- **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj.

Qytetaria:

- u jep aktualitet më të madh çështjeve, me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe qytetarisë?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuar në lëndën e historisë në kurrikulën e qytetarisë, me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimit.
- Të lidhet me kurrikulën e qytetarisë.

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm:

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.

- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.

- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.

- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

II. Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe qytetaria

1. Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj.
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj.

2. Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së qytetarisë:

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë.

- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. Në ç'mënyrë lënda e qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë? Qytetaria:

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to.

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë.
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme.
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

2.5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Procesi i të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe, në sasinë dhe cilësinë e mundshme, të kompetencave të tjera. Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe

konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet atje, atëherë dhe kur kjo është e nevojshme.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike. Nxënësi njih dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t'iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike. Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t'u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë. Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke u bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut.

Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen. Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.

Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje. Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.

Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe evropian. Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë. Nxënësi njih konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë evropian e më gjerë. Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve. Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar

tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor. Ata vlerësojnë diversitetin, respektojnë të tjerët dhe përgatiten për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise. Nxënësit zhvillojnë vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe Evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitetin kulturor në Evropë.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit, kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënies të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to. Këto tematika janë:

- Individët, grupet, shoqëria.
- Kultura.
- Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi.
- Pushteti, autoriteti, qeverisja.

2.6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Programi i lëndës së qytetarisë (Njohuri për shoqërinë klasa K-2) zhvillohet në 35 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë, për secilën klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

3. Tabela. Orët përkatëse mësimore të tematikave për klasën përgatitore

Tematika Shkalla	Individët, grupet, shoqëria	Kultura	Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Pushteti, autoriteti, qeverisja	Proceset shoqërore	Prodhimi, konsumi, shpërndarja	Totali i orëve
Shkalla 1								
Klasa përgatitore	20	10	10	5	10	5	10	70
Klasa e parë	20				8		7	35
Klasa e dytë	20				8		7	35
Shkalla 2								
Klasa e tretë	7	7			14 (7+7)		7	35
Klasa e katërt							6	35
Klasa e pestë							9	35

3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KLASAVE

Në programin e qytetarisë për të gjitha shkallët janë paraqitur rezultatet e të nxënit sipas tematikave të kurrikulës bërthamë. Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj ose grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (me kryesorët janë autorët e teksteve dhe mësuesit). Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është *relativisht* rekomanduese.

Tematika : Kultura

Nxënësit kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë, ku jetojnë, si dhe jetës dhe shoqërisë së të tjerëve dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre në emër të respektimit të diversitetit kulturor dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.

Rezultatet e të nxënit

Jemi të ndryshëm

Orë të sugjeruara: 7

<p>Nxënësit kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës.</p> <p>Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon ndryshime kulturore brenda grupit shoqëror në të cilin bën pjesë (grup, klasë, shkollë etj.) si dialekti, përparësitë në vendimmarrje në fusha të ndryshme të jetës së përditshme, siguria ose pasiguria në dialogë me shokët ose shoqet, normat morale etj. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pranon që qëndrimi i tij ndaj të tjerëve lidhet edhe me prejardhjen e tij të ndryshme; • pranon ndryshimet shpirtërore ndërmjet shokëve të klasës janë pasuri e saj dhe jo pengesë për mirëkuptim;
<p>dhe të shoqërisë, ku jetojnë ,si dhe jetës dhe shoqërisë së të tjerëve.</p> <p>Nxënësit dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre në emër të respektimit të diversitetit kulturor dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • lidh ndryshime të kësaj natyre që ka me shokët me prejardhjen ose përkatësinë e kulturës të cilës i përket. • shpreh mendime pozitive për veten dhe për shokët e "ndryshëm"; • dallon, në ndryshimet ndërmjet individëve, grupet e ndryshme kulturore; • shpjegon në mënyrë të thjeshtë ndryshimet kulturore ndërmjet grupeve të ndryshme. • pranon që qëndrimi i tij ndaj të tjerëve lidhet edhe me prejardhjen e tij të ndryshme; • pranon ndryshimet shpirtërore ndërmjet shokëve të klasës janë pasuri e saj dhe jo pengesë për mirëkuptim; 	<ul style="list-style-type: none"> • jep shembullin personal në respektimin e diversitetit në forma të ndryshme të shfaqjes së tij.
<p>Tematika : Individët, grupet, shoqëria</p>		
<p>Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.</p>		
<p style="text-align: center;">Rezultatet e të nxënët Grupi ku bëj pjesë Orë të sugjeruara: 7</p>		
<p>Njohuritë</p>	<p>Shkathësitë dhe aftësitë</p>	<p>Qëndrime dhe vlera</p>

<p>Nxënësi mëson se njerëzit në shoqëri organizohen në grupe të ndryshme për arsye të ndryshme. Pjesëmarrja në disa grupe nuk varet prej njerëzve, ndërsa në disa të tjera pjesëmarrja është zgjedhje e tyre sipas interesave.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan grupet sociale ku bën pjesë (familja, shkolla, grupi artistik, klubi i gjelbër, skuadra e lagjes etj.). • dallon interesat e përbashkëta të anëtarëve të grupit dhe tregon pse ato janë të rëndësishme për grupin; • dallon ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet anëtarëve të grupit; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregon interes për nevojat e të tjerëve; • paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; • respekton përpjekjet personale dhe ato në grup; • respekton vetveten dhe të shpreh me besim qëndrimin e tij.;
<p>Nxënësi njihet me disa nga interesat që i bashkëkojnë njerëzit në grupe të ndryshme. Këto interesa janë të larmishme, afatgjata dhe afatshkurtëra. Nxënësi i jepet mundësia të dallojë interesat që i bashkojnë njerëzit që ai njih, në grupe të caktuara dhe dallon interesat e tij dhe të të tjerëve në grupet ku bën pjesë. Nxënësi shqyrton situata të caktuara të marrëdhënieve në grupet ku bën pjesë ose nuk bën pjesë dhe veçon ato sjellje që, sipas tij, ndihmojnë në forcimin dhe jetëgjatësinë e grupit dhe ato që e pengojnë atë. Nxënësi vihet në situata të tilla që e “detyrojnë” të shprehet për rastet e shkeljes së rregullave të mirësjelljes të vendosura bashkërisht në klasën e tij dhe që dëmtojnë klimën e saj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • vendos përparësitë ndërmjet interesave të përbashkëta dhe dallimeve që ekzistojnë në një grup, nga pikëpamja e qëndrueshmërisë së grupit. • përshkruan disa nga cilësitë që duhet të ketë shoku të cilat ushqejnë miqësinë dhe solidaritetin dhe forcojnë grupin. • vlerëson miqësinë dhe solidaritetin si vlera të bashkëjetesës në grup dhe diskuton për rëndësinë dhe praninë e tyre në grupet ku bën pjesë. • tregon raste të shkeljes së rregullave të mirësjelljes dhe të diskuton pasojat e tyre për vete dhe për grupin ku bën pjesë; 	<ul style="list-style-type: none"> • pranon ide të ndryshme nga ato vetjaket etj. • tregon gatishmëri për të ndihmuar dhe respektuar shokët, të moshuarit, etj; • shfaq ndjenjën e përgjegjësisë vetjake në shtëpi, shkollë, shoqëri;
<p>Tematika : Pushteti, autoriteti, qeverisja Përmes kësaj tematike, nxënësit fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit, dhe ndërgjegjësohen që ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive, janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.</p>		

Rezultatet e të nxënit Shërbimet në komunitet Orë të sugjeruara: 7		
Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrime dhe vlera
<p>Nxënësi njihet me shërbimet e ndryshme që për të cilat kanë nevojë njerëzit që jetojnë në një komunitet.</p> <p>Nxënësi njihet me institucionet e ndryshme që i ofrojnë këto shërbime.</p> <p>Nxënësi i jepet mundësia të eksplorojë cilësinë me të cilën kryhen këto shërbime nga institucionet përgjegjëse, duke pyetur prindërit, të afërmit etj.</p> <p>Nxënësi ndihmohet të kuptojë që mirëfunksionimi i institucioneve varet edhe nga roli i komunitetit në të cilin ato ndodhen, pra bashkëveprimi me çdo anëtar të komunitetit.</p> <p>Nxënësi i jepet mundësia të dëshmojë të kuptuarit e bashkëveprimit në veprimtari të thjeshta në shkollë e komunitet.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon disa nga shërbimet për të cilat njerëzit kanë nevojë në lagjen ku banojnë (pastrimi, mbrojtja nga zjarri, parqet pushimi, kënde lojërash etj) • dallon disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime për komunitetin ku jeton (për shembull, tregon se çfarë shërbime mund ofrojnë policia, zjarrfikësit etj.); • përshkruan disa nga veprimet që janë të domosdoshme për të shfrytëzuar shërbimet e komunitetit ku jeton në rast nevoje; • tregon se çfarë mund dhe duhet të bëjnë fëmijët dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe të përfitimit prej tyre; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pranon rëndësinë e pjesëmarrjes së tij në komunitet; • përfshihet në veprimtari në dobi të komunitetit (ruajtja e gjelbërimit, në ndihmë të pleqve, etj. etj.) për të rritur sasinë e shërbimeve në komunitet.
Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe në park Orë të sugjeruara: 7		
Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrime dhe vlera
<p>Nxënësi njihet me disa nga pengesat që janë të pranishme në trotuare ose mjedise të tjera kalimi të këmbësorëve.</p> <p>Nxënësi bëhet i vetëdijshëm se rregullat duhen vendosur e zbatuar për të mos dëmtuar veten dhe të tjerët në shtëpi dhe shkollë.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon rreziqet ose pengesat e ndryshme me të cilat mund të ndeshen kalimtarët në trotuare si për shembull objekte të ndryshme etj, dhe të përcaktojë rrugë më të sigurt për të në mjedisin ku jeton; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Respekton rregullat në çdo fushë të veprimtarisë; • bashkëpunon me të tjerët për të vendosur rregulla të reja kur është e nevojshme.

<p>Nxënësi njihet me disa nga rreziqet që janë të pranishme në mjediset ku qarkullojnë njëkohësisht njerëz dhe mjete si biçikleta, motor, makina etj. Nxënësi njihet me disa nga rregullat e qarkullimit në mjedise publike (parqe, rrugë etj.) dhe përpiqet të përcaktojë disa sjellje e sigurta në rrugë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • dallon rrugët e qeta nga ato të ngarkuara si dhe disa prej rreziqeve që lidhen me to; • përdor si duhet atë pjesë të fjalorit të trafikut që lidhet me të si përdorues rruge; • flet për marrëdhëniet ndërmjet masës dhe distancës dhe të dallojë disa nga problemet që lidhen me to; • zbaton me ndihmën e të rriturve rregullat e kalimit të rrugës vetëm; • shpjegon rreziqet e lojës në rrugë; • përshkruan disa nga zgjidhjet e mundshme që i ofrohen atij në udhëtimet e përditshme; • përmend disa nga rreziqet e mundshme të pasagjerëve dhe të flasë për mundësinë e rritjes së sigurisë së pasagjerëve; • flet për rëndësinë që ka mbajtja parasysh e shpejtësisë dhe distancës për rritjen e sigurisë në rrugë; • përgatit një kënd në klasë për paraqitjen e shenjave të qarkullimit rrugor. 	
<p>Tematika: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi</p> <p>Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe reazimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.</p>		
<p>Rezultatet e të nxënit Qyteti ynë Orë të sugjeruara: 7</p>		
<p>Njohuritë</p>	<p>Shkathësitë dhe aftësitë</p>	<p>Qëndrime dhe vlera</p>
<p>Nxënësit njihen me qytetin si një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë, luajnë dhe mësojnë.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon një qytet si një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë, luajnë dhe shkojnë në shkollë; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • pranon rëndësinë e kontributit të secilit në një komunitet.

<p>Ata bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e planifikimit qytetar për zhvillimin ekonomik të një qyteti. Nxënësit shqyrtojnë rolin e ndërtuesit dhe bëhen të vetëdijshëm për lidhjen e domosdoshme të ndërtuesit me atë të projektuesit të qytetit (urbanist) Nxënësit eksplorojnë rolin e drejtuesit të një restoranti dhe punojnë në grup për të marrë vendime për funksionimin e tij. Ata përcaktojnë termat konsumator, prodhues dhe sipërmarrës. Përmes diskutimeve ata aftësohen të dallojnë ndryshimin ndërmjet konsumatorit dhe prodhuesit. Nxënësit shqyrtojnë qëllimin e një gazete si mjet komunikimi për njerëzit e një qyteti. Ata mësojnë për rolin e gazetarit dhe krijojnë vetë tituj artikujsh dhe shkrime për një gazetë klase. Përmes një loje me role fëmijët realizojnë veprime të thjeshta financiare. Ata bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e bankave për jetën e një qytet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • dallon zonat e ndryshme të qytetit të përdorura për planin e një qyteti; • flet për punën e projektuesit të një qyteti; • shpjegon rëndësinë e veprimtarisë ekonomike të ndërtimit për jetën ekonomike të qytetit; • përshkruan aftësitë që i duhen një ndërtuesi; • tregon se si puna e një ndërtuesi lidhet me atë të projektuesit të qytetit; • merr një vendim në grup, të nevojshëm për të ndërtuar një restorant; • vendos për llojin e restorantit; • diskuton dhe të përzgjedh vendin më të mirë për të ngritur restorantin; • vendos për ushqimet dhe çmimet e ushqimeve; • zgjedh punonjësi; • inauguron restorantin; • tregon rëndësinë e një gazete si një mjet komunikimi; • dallon aftësitë që i duhet një gazetari; • krijon vetë tema artikujsh dhe të skicojë rubrikat kryesore të një artikulli; • tregon se një ndër qëllimet e bankës është të ruajë paratë; • plotëson dokumentin e një veprimi të thjeshtë bankar; • bën një bilanc të thjeshtë personal; 	<ul style="list-style-type: none"> • respekton të gjitha llojet e punëve
--	---	---

Planifikimi mësimor vjetor dhe tremujor Fusha: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: Qytetari

Planifikimi vjetor i lëndës: “Qytetaria 3”

Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës

Tematikat (Shkalla 2)	Shtator-Dhjetor (12 orë)	Janar-Mars (12 orë)	Prill-Qershor (12 orë)
Tematika 1. Kultura (7 orë)	7 orë		
Tematika 2. Individët, grupet, shoqëria (7 orë)	5 orë	2 orë	
Tematika 3. Shërbimet në komunitet (7 orë)		7 orë	
Tematika 4. Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe park (8 orë)		3 orë	5 orë
Tematika 5. Prodhimi, konsumi, shpërndarja (7 orë)			7 orë

PLANIFIKIMI VJETOR

Tematikat (Shkalla 2)	Shtator-Dhjetor (12 orë)	Janar-Mars (12 orë)	Prill-Qershor (12 orë)
Tematika 1. Kultura (7 orë)	1.1. Unë jam i veçantë 1.2. Shumë kultura një vend 1.3. Ndryshimi është pasuri 1.4. Respekti ndaj ndryshimeve të kulturës 1.5. Jemi të ndryshëm 1.6. Luaj dhe mëso: Rrëfimi i historisë sime 1.7. Veprimtari: Festojmë kultura të ndryshme në klase	2.6. Luaj dhe mësoj: Shok i mirë 2.7. Veprimtari: Vlerësoj miqësinë 3.1. Unë jetoj këtu 3.2. Njerëzit në komunitetin tim. 3.3. Komuniteti është i yni. 3.4. Veprimtari në komunitetin tim. 3.5. Qeverisja vendore	4.4. Sinjalet në rrugë 4.5. Unë bëj zgjedhjet e duhura. 4.6. Përmbledhje: Shkaqe dhe pasoja. 4.7. Veprimtaria: Ne jemi qytetarë të përgjegjshëm në rrugë 5.1. Qyteti ynë: Një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe argëtohen 5.2. Qyteti ynë: Një vend ku njerëzit shpenzojnë para 5.3. Qyteti ynë: Një vend ku njerëzit kryejnë veprime bankare 5.4. Qyteti ynë: Një vend ku njerëzit hapin biznese të reja 5.5. Qyteti ynë: Një vend ku njerëzit komunikojnë 5.6. Veprimtari 5.7. Test përfundimtar
Tematika 2. Individët, grupet, shoqëria (7 orë)	2.1. Unë dhe vlerat e mia 2.2. Ne dhe interesat tona 2.3. Le të bashkëpunojmë 2.4. Respekti ndaj vetes, respekti ndaj të tjerëve 2.5. Miqësia është e rëndësishme	4.1. Unë jam i përgjegjshëm në rrugë 4.2. Siguria varet dhe nga unë 4.3. Rruga është e të gjithëve	
Tematika 3. Shërbimet në komunitet (7 orë)			
Tematika 4. Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe park (7 orë)			
Tematika 5. Prodhimi, konsumi, shpërndarja (7 orë)			

**Planifikimi 3-mujor për lëndën: “Qytetaria 3”
Shtator - Dhjetor**

Numri	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënimit	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve	Vlerësimi	Burimet, materiale didaktike
1	Kultura <i>7 orë</i>	1.1. Unë jam i veçantë	Prezantimi i vetes	Dil rrotull, fol rrotull, të nxënit në bashkëpunim, turi i galerisë	Vlerësim formues	Foto të familjes, album
2		1.2. Shumë kultura një vend	Llojet e familjeve	Tryeze rrethore, pune me grupe, diskutim	Vlerësim formues	Objekte, tradicionale, hartë e botës dhe e Shqipërisë
3		1.3. Ndryshimi është pasuri	Përfjetime personale	Lojë, punë me grupe, shkrim i lirë	Vlerësim përmbledhës	Objekte, tradicionale, hartë e botës dhe e Shqipërisë
4		1.4. Respekti ndaj ndryshimeve të kulturës	Përvoja personale, lojë	Parashikime me terma paraprakë, vëzhgo mendo, krijo dyshe	Vlerësim përmbledhës	Objekte balte, kashte, figura, kartolina

5	Kultura 7 orë	1.5. Jemi të ndryshëm	Përvojë personale	Stuhi mendimesh, lexim i drejtuar, punë me grupe	Vlerësim formues	Foto, CD, magnetofon
6		1.6. Luaj dhe mëso: Rrëfimi i historisë sime	Lojë	Diskutim, lojë	Vlerësim përmbledhës	Zare, fisha
7		1.7. Veprimtari: Festojmë kultura të ndryshme në klase	Veprimtari në grup	Veprimtari praktike	Vlerësim përmbledhës	Veshje, objekte, gatime tradicionale nga vendi dhe bota
8	Tematika 2. Individët, grupet, shoqëria 5 orë	2.1. Unë dhe vlerat e mia	Përjetime personale	Pyetje – përgjigje, të nxënësit në bashkëpunim, shkrim i lirë	Vlerësim formues	Albume, Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
9	Tematika 2. Individët, grupet, shoqëria 5 orë	2.2. Ne dhe interesat tona	Shkëmbim përvojash vetjake	Parashikim me terma paraprake, diskutim, punë individuale,	Vlerësim formues	Albume, foto
10		2.3. Le të bashkëpunojmë	Situata nga jeta e përditshme	Di! Dua të di! Mësova!	Vlerësim përmbledhës	Foto
11		2.4. Respekti ndaj vetes e të tjerëve	Shkëmbim përvojash vetjake	Pesëvargësh, lexim me fragmente, punë me grupe	Vlerësim përmbledhës	Albume, Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
12		2.5. Miqësia është e rëndësishme	Situata konkrete nga jeta e përditshme	Stuhi mendimesh, vëzhgo diskuto, lojë me rol	Vlerësim formues	Albume, foto

Planifikimi 3-mujor për lëndën: “Qytetaria 3”
Janar - Mars

Numri	Tematika	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve	Vlerësimi	Burimet, materiale didaktike
1	Individët, grupet, shoqëria 7 orë	2.6 Luajmë dhe mësojmë: Shok i mirë	Lojë	Diskutim paraprak, lojë në grupe, shkrim i lirë	Vlerësim formues	Zare, grafikë
2		2.7 Aktivitet: Vlerësojmë miqësinë	Situatë Ndërvepruese	Parashikim nëpërmjet titullit, veprimtari me grupe, turi i galerisë	Vlerësim formues	Harta e Shqipërisë, Shirita letre, Teksti
3	Shërbimet në komunitet 7 orë	3.1 Unë jetoj këtu	Pamje me foto ose video projektor	Të nxënit bashkëveprues	Vlerësim përmbledhës	Projektor, CD, Albume, Teksti
4		3.2 Njerëzit në Komunitetin tim	Përvoja nga jeta në Komunitet	Stuhi mendimesh, të nxehtë bashkëpunues, turi i galerisë	Vlerësim përmbledhës	Projektor, CD, Albume, Teksti
5	Shërbimet në komunitet 7 orë	3.3 Komuniteti është yni	Diskutime me pjesëtarë të Komunitetit	Lapsa në mes, lexim me fragmente, shkrim i lirë	Vlerësim formues	
6		3.4 Veprimtaritë në Komunitet	Veprimtari praktike për shërbime në Komunitet	Metoda gjithëpërfshirëse	Vlerësim përmbledhës	

7		3.5 Qeverisja vendore	Diskutime rreth shërbimeve e punëve në Komunitet.	Di – Dua të di – Mësova	Vlerësim përmblendhës	Grafikë, Harta
8		3.6 Luaj dhe mësoj: Komuniteti im	Situatë loje: Metoda gjithëpërfshirëse	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë	Vlerësim formues	Grafikë, Harta
9	Shërbimet në komunitet 7 orë	3.7 Veprimtari: Ndërtojmë së bashku komunitetin tonë	Veprimtari në grup	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë	Vlerësim përmblendhës	Kuti kartoni, Puzzle ngjitës, Lodra të vogla, shishe plastike...
10	Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe park 7 orë	4.1 Unë jam i përgjegjshëm në rrugë	Përvoja nga jeta për sigurinë në rrugë.	Parashikim nëpërmjet titullit, vëzhgo – mendo – diskuto – Lojë	Vlerësim formues	Kodi rrugor, tabela rrugore, projektor
11		4.2 Siguria varet dhe nga unë	Përvoja nga jeta e përditshme në qarkullimin në rrugë.	Metoda gjithëpërfshirëse	Vlerësim formues	Kodi rrugor, tabela rrugore, projektor
12		4.3 Rruga është e të gjithëve	Situata në foto ose projektor ose të rrugëve të vendit.	Mësimdhënie e drejtpërdrejtë	Vlerësim formues	Kodi rrugor, tabela rrugore, projektor, zare, hartë

**Planifikimi 3-mujor për lëndën: “Qytetaria 3”
Prill - Qershor**

Numri	Tematika	Tema mësimore	Situata e Parashikuar e te nxënit	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve	Vlerësimi	Burimet materiale didaktike
1	Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe park <i>7 orë</i>	4.4 Sinjalet në rrugë	Vëzhgim në rrugë i sinjalistikës rrugore	Metoda Gjithëpërfshirëse	Vlerësim formues	Kuti kartoni, Puzzle ngjitës, Lodra të vogla, shishe plastike ...
2		4.5 Unë bëj zgjedhjen e duhur	Diskutime rreth rreziqeve të mundshme, në rrugë	Metoda Gjithëpërfshirëse	Vlerësim formues	Kodi rrugor, tabela rrugore, projektor
3		4.6 Luaj dhe mësoj; Lëviz i sigurt	Lojë	Parashikim me terma paraprakë – Lojë, diskutime	Vlerësim përmbledhës	Kodi rrugor, tabela rrugore, projektor, zare.
4		4.7 Veprimtari: Ne jemi qytetarë të përgjegjshëm në rrugë	Si të sillemi në rrugë?	Veprimtari praktike	Vlerësim përmbledhës	Tabela sinjalistike rrugore, harta, karton, gërshtëre, Puzzle
5	Qyteti ynë <i>7 orë</i>	5.1 Qyteti ynë: një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë, dhe argëtohen.	Diskutim mbi filmin, foto, kartolina.	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	Foto, kartolina, Projektor
6		5.2 Qyteti ynë: një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë, dhe argëtohen.	Ekskursion neper qytet	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	

7		5.3 Qyteti ynë: një vend ku njerëzit, shpenzojnë, para.	Diskutim, situata shitje blerje	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	Artikuj te ndryshëm, ushqimor, veshje, kancelari, etiketa me çmime.
8		5.4. Qyteti ynë një vend ku njerëzit kryejnë veprime Bankare.	Ekskursion ne nje Banke te nivelit te dyte.	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	
9	Qyteti ynë 7 orë	5.5. Qyteti ynë ku njerëzit hapin biznese të reja.	Diskutim rasti	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	Mjete me material të riciklueshëm, lodra, veshje.
10		5.6. Qyteti ynë ku njerëzit hapin biznese të reja.	Veprimtari praktike	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	Mjete me material të riciklueshëm, lodra, veshje.
11		5.7 Qyteti ynë një vend ku njerëzit komunikojnë	Përvoja personale; Lajmi shpërndahet	Gjithëpërfshirëse	Vlerësim Formues	Postera, fletëpalosje, megafon, mikrofon.

Tematika 1. Kultura 7 orë**Planifikim i orës mësimore 1.1**

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Unë jam i veçantë		Situata e të nxënit: Prezantimi i vetes	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh mendimin e vet me gojë ose shkrim në lidhje me temën. • Dallon ndryshime kulturore brenda grupit shoqëror në të cilin bën pjesë. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës, sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon ngjashmërinë dhe ndryshimet mes moshatarëve. • Prezanton veten para shokëve. • Ndërton diagramin e familjes së tij. 	
Fjalë kyçe: Ndryshim, origjinë, ngjashmëri, larmishmëri, diagram		Burimet: Teksti i nxënësit, figura ilustruese, album i familjes, fletë A4	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Art Pamor		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Dil rrotull, fol rrotull, Të nxënit në Bashkëpunim, Turi i Galerisë	
Organizimi i orës së mësimi: <ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimi: Dil rrotull, fol rrotull Mësuesi/ja mund të fillojë mësimin me këtë teknikë. Nxënësit lëvizin lirshëm nëpër klasë. Mësuesi/ja shkruan në tabelë pyetjen: <i>Cili je ti?</i> Në momentin që jepet komanda: STOP! nxënësit kapen në dyshe përballë njëri-tjetrit dhe shkëmbejnë mendime rreth pyetjes, në përfundim mësuesja pyet: <i>Çfarë mësuat nga shoku?</i> 2. Ndërtimi i njohurive - Të nxënit në bashkëpunim: Mësuesi/ja prezanton temën dhe shpjegon përpara nxënësve: Çdo individ është i ndryshëm. Të tillë na bën pamja e jashtme, sjellja, dëshirat, origjina domethënë prejardhja, familja nga vijnë, fshati, qyteti, vendi. Në këtë mënyrë bëhet prezantimi i tri personazheve në figurë. Figura 1. Ema, vajzë 8-9 vjeçe me tipare me ngjyrë, pra mund të jetë me prejardhje me ngjyrë, këtu mësuesi/ja shpjegon kuptimin e fjalës prejardhje -> zanafilla nga diku e një grupi shoqëror të caktuar (me ose pa lidhje gjaku). Figura 2. Albani, (Përshkrimi fizik i fotos, tipar i veçantë përdor syze, natyrë me humor) Figura3. Blini, moshatar i tyre, i qetë, ka pasion ushqimin. Këtu nxënësit shprehin mendimin e tyre për cilësitë që i bëjnë të ndryshëm, mësuesi/ja thekson se pavarësisht këtyre cilësive fëmijëve u pëlqen të rrinë bashkë. Ata kanë nevojë për njëri-tjetrin, ndryshimi është vlerë për këdo. 			

Veprimtari praktike: Punimi faqes 7, nxënësit formojnë grupe katërshe. Secili grup shkruan pesë cilësi për veten.

Ndërtojnë diagramin e Venit, dhe bëjnë komentet.

Veprimtaria 2: Vëzhgimi i diagramit të familjes dhe plotësimi me simbolin e duhur për përgjigjen e saktë.

- Përgjigjet e sakta janë:
1. Babai i Jonës, Agimi
 2. Më i vogli, Drini
 3. Mamaja e Drinit, Mira
 4. Vera dhe Agimi kanë dy fëmijë.

Nxënësit punojnë të pavarur për të vizatuar diagramin e familjes së tyre.

3. Turi i Galerisë: Nxënësit ekspozojnë vizatimet, vëzhgojnë dhe komentojnë punët e njëri-tjetrit.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime, fjalorin e përdorur, plotësimin e diagrameve.

Detyrë: Sillni foto të familjes suaj.

Planifikim i orës mësimore 1.2

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Shumë kultura, një vend		Situata e të nxënit: Llojet e familjeve	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësoi rolin e kulturës në formimin e jetës dhe shoqërisë. • Lidh ndryshime të kësaj natyre që ka me shokët me prejardhje ose përkatësinë e kulturës që i përket. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës, sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Prezanton ndryshimet mes vetes dhe moshatareve. • Tregon traditat e familjes së tij. • Përcjell zakone të familjes së trashëguara brez pas brezi. 	

<p>Fjalë kyçe: zakone, traditë, dialekt, veshje, paraardhës, muzikë, valle, histori, arkitekturë, përralla, legjenda</p>	<p>Burimet: Teksti, harta e Shqipërisë, objekte balte, bakri, kashte, punime leshi, qëndisma, elemente të kostumeve popullore, foto, kartolina, CD me këngë e valle popullore, magnetofon</p>
<p>Lidhja me fusha të tjera ose me temat nderkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, arte</p>	<p>Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Tryeza rrethore, Punë dyshe, Punë në grupe, Diskuto</p>
<p>Organizimi i orës së mësim: 1. Parashikimi: Tryeza rrethore Në këtë teknike nxënësit vendosen në tryeza rrethore . Një letër dhe një laps pasohet sistematikisht rreth grupit. Secili nxënës shkruan emrin e qytetit, fshatit, vendit nga vijnë familjet e tyre. Dëgjohen mendimet e tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Punë me grupe, punë dyshe. Mësuesi/ja prezanton tekstin fq. 8. Në hartën e Shqipërisë ftohen nxënësit të gjejnë qytetet e tyre. Këtu mësuesi/ja ndërhy duke treguar shtrirjen gjeografike të krahinave dhe disa elemente karakteristike të tyre. Shembull: “Veriu i Shqipërisë përfshin Shkodër, Tropojë , Pukë, Kukës.” Mësuesi/ja shpjegon konceptet bazë. Çdo njeri vjen nga një familje. Çdo familje ka paraardhës, -> Të parët e përbashkët kundrejt brezave të mëvonshëm, që kanë lidhje gjaku me ta, katragjyshër, stërgjyshër, gjyshër... Ata kanë jetuar në qytet, fshat dhe për arsye të ndryshme kanë ndryshuar vendbanim. Por kanë ruajtur gjuhën, kulturën, traditat, që ua kanë lënë të parët. Tradita do të thotë mënyra e të jetuarit, zakonet, organizimet e besimit fetar, veshjet, objekte, orendi, këngë, valle e përralla. Këtu mësuesi/ja bën shpjegimin në hartën e tekstit, shembull: “Lahuta -> Instrument muzikor i përdorur në zonën e veriu të Shqipërisë, (në CD ftohen nxënësit të dëgjojnë një pjesë në Lahutë. Figura 2. Në hartë veshja popullore, i përket zonës së Tropojës. Figura 3. Valle e Shqipërisë së mesme (dëgjim dhe kërcim në grup). Figura 4. Qyteti i Beratit (qyteti 2400 vjeçar, qyteti i një mbi një dritareve, për arkitekturën e ndërtimit të banesave, rrugica me kalldrëm të punuar nga gurëgdhensit e qytetit të njohur deri në Turqinë e asokohe, në profesione (zanate), të cilat mund të trashëgohen.)</p> <p>Veprimtaria: Punimi i faqes 9 Ne grupe katërshe, nxënësit sjellin përjetime personale nga vendet që kanë vizituar në Shqipëri ose flasin për fshatin apo qytetin e tyre të origjinës. Ushtrimi 2. Zgjidhja e gjëgjëzës; Lakror (byreku në saç që gatuhet në zonën e Korçës.)</p> <p>Ushtrimi 3. Ekspozita me objekte që nxënësit kanë sjellë në klasë. Ata përcjellin histori të trashëgimisë familjare.</p>	

3. Përforcime, diskuto

Nxënësit diskutojnë për legjendat, përrallat që i kanë dëgjuarit nga paraardhësit e tyre.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje në diskutime, përgjigje në pyetje dhe fjalorin e pasur në argument të fakteve.

Detyrë: Shkruaj një histori të rrëfyer nga paraardhësit e tu.

Planifikim i orës mësimore 1.3

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Ndryshimi është pasuri		Situata e të nxënët: Përjetime personale	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Jep shembullin personal në respektimin e diversitetit në forma të ndryshme të shfaqjes së tij. Bashkëpunon në grup, duke respektuar kulturën dhe zakonet e tjetrit. 		Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Diskuton për zakonet, mënyrën e të jetuarit të familjes së tij. Përshkruan me gojë e shkrim përgatitjet për festë në familje. 	
Fjalë kyçe: Kulturë, zakon, festë tradicionale, artizanat		Burimet: Figura ilustruese, teksti, fotografi vetjake	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Lojë, punë me grupe, shkrim i lirë	
Organizimi i orës së mësimet: <p>1. Parashikim i lojës Mësuesi/ja fton nxënësit të ndahen në ambiente klase dhe të improvizojnë situatë përshëndetje me njëri-tjetrin. Lihen të lirë të përdorin forma të ndryshme përshëndetjeje. Mësuesi/ja ka nënvizuar në tabelë disa forma përshëndetjeje (me dorë, me përqaftim, shuplakë).</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive Punë me grupe, prezantimi i mësimet faqe 10. Vërehen figurat dhe komentohen me nxënësit. Fëmijët përshëndeten në forma të ndryshme. Edhe përshëndetja është një lloj kulture, të përshëndetësh tjetrin është qytetari.</p>			

Shembull: -> Skuadrat e sportisteve toraksin duart përpara se të fillojë ndeshja. Në familje, ne mësojmë të duam njëri-tjetrin dhe të tjerët të respektojmë kulturën përkatësinë fetare të fqinjët.

Veprimtaritë: Nxënësit sjellin përvoja të ushqimeve të veçanta që mund të kenë provuar te të afërm, fqinj apo kur kanë lëvizur me familjen. Komentohen figurat.

Figura 1. Anës i pëlqen të hajë picë (gatim i kuzhinës italiane)

Figura 2. Kinezët hanë ushqimet me shkopi të posaçëm.

Figura 3. Në disa kultura të vendeve të Lindjes, hanë me duar.

Punë individuale: Nxënësit ilustronë tryezën e familjes së tyre në një ditë festive.

Me shkrim nxënësit shkruajnë, veprimet e çdo anëtari të familjes për t'u përgatitur për festë.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për fjalorin e pasur, komentet dhe argumentet e dhëna dhe ilustrimet.

Detyrë: Përshkruani një ushqim që do të donit ta provonit jetën e një kulture tjetër.

Planifikim i orës mësimore 1.4

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Respekti ndaj të ndryshmit		Situata e të nxënit: Përvoja personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Shpreh mendime pozitive për veten dhe shokët “e ndryshëm”. • Jep shembuj personalë në respektimin e diversitetit në forma të ndryshme të shfaqjes së tij. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Mban qëndrim ndaj “sjelljeve” ndryshe. • Shpreh me shkrim mendimin e tij ndryshe. 	
Fjalë kyçe: diskriminim, nofkë		Burimet: teksti, figura ilustruese	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë – Vëzhgo-Mendo-Krijë- Ndryshe Punë individuale	

Organizimi i orës së mësimit:

1. Parashikim me terma paraprakë

Mësuesi/ja shkruan në tabelë këto fjalë: “RESPEKT , NOFKË, SHOK, SJELLJE, E DREJTË,”

U kërkon nxënësve të krijojnë , një tekst të shkurtër me gojë ku të përdorin fjalët e mësipërme, dëgjohen mendime te ndryshme të nxënësve.

2. Ndërtim i njohurive – Vëzhgo-Mendo-Krijo-Ndryshe

Prezantimi i temës. Shpjegimi i mësuesit/es për konceptet kyçe: Diskriminim –Të dallosh nga të tjerët dikë, ta trajtosh keq duke mos e quajtur të barabartë, t’i kufizosh të drejtat. Kjo është një sjellje që cenon lirinë e tjetrit.

Puna me librin.

Figura 1. Ndoshta të mbajturit syze e bën atë të ndryshëm? I vendos nofkë? (E fyen?) Jepni mendimin tuaj.

Figura 2. Djalit i përflasin dhe i pëshpëritin prapa krahëve. Ky veprim është diskriminim.

Figura 3. Shoqet e trembin, e kërcënojnë. Kjo është shkelje e lirisë dhe formë diskriminimi.

Veprimtari: Nxënësit në dyshe diskutojnë për situatat e fq. 13. Ata japin mendimin e tyre për një ngjarje apo situatë të ngjashme me tekstin dhe argumentojnë mendimin e tyre pse është diskriminues.

3. Përforsim; Punë individuale: Shkruaj dy mesazhe për shokët në lidhje me temën.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për formulimin e teksteve, diskutimin e situatave dhe argumentet e fakteve dhe mesazhet e përcjella.

Detyrë: Shkruaj një rast kur je ndjerë se të kanë bërë një veprim të padrejtë.

Planifikim i orës mësimore 1.5

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Jemi të ndryshëm por bashkë		Situata e të nxënët: Situata dhe përvoja personale	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pranon se ndryshimet ndërmjet shokëve të klasës janë pasuri dhe jo pengesë për mirëkuptim. • Bashkëvepron në grup, duke respektuar mendime ndryshe. 	<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Jep shembullin personal ne respektimin e shokëve. • Respekton rregullat e punës në grup.
<p>Fjalë kyçe: shajak, temina, qeleshe, fustanellë</p>	<p>Burimet: teksti, figura ilustruese, kartolina</p>
<p>Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, arte pamore</p>	<p>Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve; Stuhi mendimesh, Lexim i drejtuar, Punë me grupe</p>
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>1. Parashikimi: Stuhi mendimesh. Mësuesi/ja drejton pyetje rreth veshjeve tradicionale që ata kanë parë. Paraqiten kartolina me veshje popullore të vendit dhe nxënësit identifikojnë ato që njohin. Vërehen motivet, format, ngjyrat. Këtu mësuesi/ja bën shpjegimin e elementeve të tyre. Shembull: Shajaku , stof i lehtë i trashë i punuar në evegje që përdoret për veshje popullore, fustanelle -> pjesë e kostumit shqiptar për burra si fund me pala me pëlhurë të bardhë (krahina e Jugut të Shqipërisë).</p> <p>2. Ndërtim i njohurive: Lexim i drejtuar. Prezantim i tekstit fq. 14. Lexim me fragmente dhe diskutim i situatës; Ç’problem lindi mes Hanës dhe Adës? Si e zgjidhën vajzat problemin? A kishin zgjidhje tjetër? Kujt iu drejtuan për ndihmë? Mund t’ia dilnin vetë ta zgjidhnin problemin?</p> <p>Veprimtari: Punë me grupe. Nxënësit formojnë grupe katërshe . Krijojnë një histori . Brenda grupit ka mosmarrëveshje. Si e zgjidhët? Në hyrje të shtëpisë shkruhet problemi. Dritarja majtas paraqet alternativa për zgjidhje a. zgjidhe vetëm b. kërkon ndihmë c. mos dëgjo shokët d. bashkëpuno D dritarja djathtas kërkon shkrimin e problemit dhe në krye jepet zgjidhja, atë që grupi argumenton si më të mirën e mundshme. Grupet argumentojnë plotësimin e shtëpisë dhe gjetjen e zgjidhjes me mirëkuptim dhe qytetari.</p> <p>3. Përforsim: Punë me grupe. Shembull: Lind mosmarrëveshje për ndarjen e roleve brenda grupit. Mosmarrëveshje për pjesëmarrje në konkursin e recituesve. Ndarjen e roleve në një pjesë teatrale.</p> <p>Nxënësit luajnë rolet e mësipërme, duke respektuar njëri-tjetrin.</p>	

Vlerësimi: Për fjalorin e pasur, gjuhën e përdorur, sjelljet dhe komunikimin me njëritjetrin, gjatë zgjidhjes së situatave.

Detyrë: Trego një shembull bashkëpunimi me shokun tënd.

Planifikim i orës mësimore 1.6

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Luaj dhe mëso: Rrëfimi i historisë sime		Situata e të nxënit: Lojë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Demonstron aftësi të bashkëpunimit mes individëve në grupin ku bën pjesë, duke pranuar diversitetin. • Bashkëvepron me të tjerët, duke zbatuar rregullat e lojës. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Luan sipas rregullave të lojës • Respekton shokun-shoqen gjatë lojës. • Argumenton veprimet brenda grupit. 	
Fjalë kyçe: lojë, rregulla, zare, destinacion, autizëm		Burimet: Figura ilustruese, teksti, zare	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Diskutim, lojë	
Organizimi i orës së mësimt: 1. Parashikimi: Diskutim. Mësuesi/ja prezanton temën. Hapen librat në faqen 16. Vëzhgohet loja dhe mësuesi/ja u shpjegon rregullat e saj. 2. Lojë. Nxënësit mësojnë të luajnë sipas rregullave dhe të përballen me pasojat kur nuk respektohen rregullat. Kalitet durimi, përqendrimi, respekti ndaj lojtarit tjetër dhe çuarja e lojës deri në fund. Loja luhet në ketë mënyrë; hidhet zari dhe lojtari lëviz sa tregon numri që bie në skemë, ra numri 5 (me supozim) numëro nga fillimi 5 kuti, të del shënimi; Filmi i preferuar – Lojtarët e tjerë i kërkojnë shokut të përshkruajnë filmin, me të paktën 3 folje... Por loja ka të papritura. Nëse zari të bie në kutinë rozë je me fat, t'i do të lëvizësh 5 kuti të tjera përpara. Nëse të bie në kutizën e zezë, duhet të bësh kthim prapa. Pasi mësohen rregullat, nxënësit ndahen në grupe e fillojnë lojën. Këtu nis diskutimi brenda grupit. Nxënësit arrijnë marrëveshje e gjejnë zgjidhje se cili do e hedh zarin i pari. Kështu zbatohen mesazhet e fituara për zgjidhjen e situatave dhe pranimin e mendimeve të të tjerëve vetëm me qytetari.			

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për organizimin e lojës dhe zbatimin e rregullave gjatë saj.

Detyrë: Krijohet një lojë me rregulla dhe mësojua atë shokëve.

Planifikim i orës mësimore 1.7

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Aktivitet: Bota në klasën time		Situata e të nxënit: Veprimtari festive në grup	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, internet) dhe i shfrytëzon për realizim teme. • Merr pjesë në aktivitete që provojnë tolerancë e diversitet kulturor, etnik, fetar. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon 3-4 tradita të krahinës së tij. • Përshkruan tradita të vendeve të tjera. • Ekspozon objekte, gatime, të kulturave të ndryshme. 	
Fjalë kyçe: Festojmë breza, krahinë, suvenire		Burimet: Prodhime artizanale, veshje popullore, Cd me këngë e valle popullore, aparat fotografik, litar, top, spango	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Arte, Gjuhe komunikim , Sporte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxenesve; Dil rrotull, fol rrotull, Veprimtari në grupe, Turi i galerisë	
Organizimi i orës së mësimimit: <p>1. Parashikimi: Dil rrotull fol rrotull. Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe i tregojnë njëri-tjetrit si festojnë në familje festat e ndryshme tradicionale. Ata përshkruajnë sende e objekte të vjetra që kanë parë e vizituar me familjaret e tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Veprimtari në grupe Mësuesi/ja përzgjedh që këtë orë ta organizojë në oborrin e shkollës ose palestër. Ajo mund të ftojë dhe prindërit dhe së bashku të organizojnë, “Ditën e traditës”. Përzgjidhen elemente tradicionale për t’u ekspozuar nga grupet e nxënësve. Krijohet këndi i objekteve të trashëgimisë familjare, Grupi I, Grupi II. Ekspozohen punime me dorë (qëndisma, thurje). Grupi III, ekspozon ushqime tradicionale të zonës.</p> <p>Grupi IV, Valle popullore (interpretohen në një kënd të oborrit)...</p> <p>Në tekst ka larmi aktivitete. Mësuesi/ja zgjedh ato që mund të realizojë me nxënësit. Momentet e bukura fiksohen në aparate fotografike dhe mbesin kujtime të paharruara.</p>			

Vlerësimi: Vlerësimi përmbledhës për aktivitete e bashkëpunim në grup e mesazhe që përcillen nga nxënësit.

Detyrë: Vizatoni çastet më të bukura për ju.

Planifikim i orës mësimore 2.1

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Unë dhe vlerat e mia		Situata e të nxënit: Përjetime personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan grupet sociale ku bën pjesë. • Dalloi interesa të përbashkëta të anëtarëve të grupit. • Tregon raste të shkeljes së rregullave brenda grupit. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon 3-4 cilësi të vetes. • Përshkruan tipare e cilësi të miqve. • Argumenton sjellje të pëlqyeshme dhe të papëlqyeshme brenda grupit. 	
Fjalë kyçe: Vlerë, interesa, pasione		Burimet: teksti, figura ilustruese	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Marrëdhënie pyetje-përgjigje, Të nxënit në bashkëpunim, Shkrim i lirë	
Organizimi i orës së mësimimit: <p>1. Parashikimi: Marrëdhënie pyetje-përgjigje. Mësuesi/ja nxit nxënësit t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit rreth cilësive, pasioneve dhe sjelljeve të tyre. Shembull: Tregoji shokut çfarë të pëlqen te vetja...</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Të nxënit në bashkëpunim. Mësuesja prezanton temën. Ajo nis me shpjegimin e fjalëve kyçe dhe me ndihmën e nxënësve bëhet zbërthimi i fjalës -vlerë -> cilësi të karakterit tënd të pëlqyeshme të pranueshme nga të tjerët. E rëndësishme është të pranosh veten me të mirat dhe dobësitë. Ti ke cilësi pozitive dhe këto tregojua me vepra atyre që ke përreth. Leximi poezisë “Derrkuca që donte veten”. Personazhi simpatik i Derrkuces në bisedë me pasqyrën na mëson ta duam veten ashtu si jemi. Bashkë me nxënësit gjenden në tekst shprehjet përshkruese që përdor personazhi. Komentohen figurat dhe krahasohen cilësitë e “Derrkuces”.</p>			

Veprimtaria: Në grupe katërshe, nxënësit diskutojnë se si Derrkuçja mëson të garojë me patina. Ajo ka pranë edhe mbështetjen e shokëve. Kjo e stimulon për të ecur përpara. Reflektimi i nxënësve për situata të ngjashme, argumentimi përpara grupit.

3. Përforcim: Shkrim i lirë. Nxënësit përshkruajnë me shkrim cilësinë me të mirë që kanë te vetja. Argumentojnë me fjalor të pasur me të paktën 3-4 fjali përgjigjen. Dëgjohen mendimet dhe ndahen idetë me shokët. Mesazhi përcillet fuqishëm prej tyre.

Vlerësimi: Vlerësimi përmbledhës për hartimin e pyetjeve, komentet, analizën e vargjeve dhe përcaktimin e vlerave te vetja.

Planifikim i orës mësimore 2.2.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Ne dhe interesat tona		Situata e te nxënit: Përjetime personale	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Vendos përparësitë ndërmjet interesave të përbashkëta dhe dallimeve që ekzistojnë në grup, nga pikëpamja e qëndrueshmërisë së grupit. Prezanton disa nga interesat që i bashkojnë njerëzit në grupe të ndryshme. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Tregon interesa te tij përpara grupit. Argumenton interesa të përbashkëta dhe respektimin e tyre. 	
Fjalë kyçe: interesa, pasione		Burimet: teksti, foto personale, libra artistikë, vegla muzikore...	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Dituri natyre, Arte sporte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë -Diskutime-Punë individuale	
Organizimi i orës së mësimi: <p>1. Parashikimi: Parashikim me terma paraprakë. Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët “Dëshirë”, “Interesa”, “Pëlqej”, “Gjykim”, “Respektoj”, “Argëtohem”. Për disa minuta, nxënësit krijojnë histori me gojë dhe ua rrëfejnë shokëve. Pranohen të gjitha mendimet e tyre.</p> <p>2. Ndërtim i njohurive. Diskutime Mësuesi/ja prezanton temën. Bëhet leximi tekstit faqe 24. Ai/ajo drejton pyetje: <i>Çfarë pasioni ka Drini?</i> Merr mendimet e nxënësve rreth fjalës pasion, me pas shpjegon kuptimin e saj. Pëlqen më shumë të bëjë sport, të merret me muzikë etj.</p>			

Të gjithë kanë pëlqime të ndryshme nga tjetri, kjo i bën të veçantë. Por e rëndësishme është që ne të pranojmë pëlqimet e shokëve, idetë e ndryshme dhe t'i respektojmë ato. Nxënësit komentojnë figura dhe shprehin pëlqimet e çdo personazhi. Mësuesi/ja ndërhyr duke kërkuar të bëjmë paralelizëm me pëlqimet e tyre.

3. Përforcimi: Pune individuale. Secili nxënës liston në tabelë interesat e tij, të shokut-shoqes dhe interesat e përbashkëta. Në përfundim secili argumenton punën e tij dhe shpreh fuqishëm mesazhin. Të gjithë duhet të respektojnë pëlqimet e njëri-tjetrit dhe të mos e gjykojnë atë.

Vlerësimi: Vlerësimi përmbledhës për krijimin e tekstit me gojë, komentet dhe listimin e interesave dhe mesazhet e sjella.

Detyrë: Ilustro një interes që ke të përbashkët me shokun.

Planifikim i orës mësimore 2.3

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Le të bashkëpunojmë		Situata e të nxënit: Situata nga jeta e përditshme	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Prezanton disa nga interesat që i bashkojnë njerëzit në grupe të ndryshme. • Tregon raste të shkeljes së rregullave të grupit dhe pasojat për vete dhe grupin ku bën pjesë. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Shfaq ndjenjën e përgjegjësisë vetjake në shkollë, familje, shoqëri. • Sjell shembuj të bashkëpunimit në grup. • Argumenton pasojat e mosrespektimit të rregullave brenda grupit. 	
Fjalë kyçe: përgjegjësi, pasojë, drejtësi, emocion, bashkëpunim		Burimet: teksti, figura ilustruese	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, lëndë me zgjedhje		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Di! Dua të di! Mësova!	
Organizimi i orës së mësimi: <p>1. Parashikimi DI! Mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë çfarë dinë për rregullat. Ai/ajo shkruan në tabelë gjithçka. Nxënësit flasin. Ndërtimi i njohurive, “Dua të di”. Mësuesi/ja prezanton temën dhe shkruan në kolonë të gjitha pyetjet që i lindin nxënësve në moment.</p>			

Shembull: “Në cilin grup bën pjesë?” “Çfarë Detyrë ke në grup?”
Hapen librat, lexohet teksti dhe bëhet komenti i figurave, nxënësit përcaktojnë grupet pjesëmarrëse të fëmijëve. Diskutohen përgjegjësitë që ata kanë në familje, klasë, lojë. Rregullat i kanë vendosur vetë njerëzit që shoqëria të ecë përpara. Shpesh kur bën zgjedhje të gabuar apo nuk zbaton rregulla mbetesh jashtë grupit. Me ndihmën e mendimin e shokëve bën zgjidhjen e duhur brenda grupit, ku punët ndahen e të gjithë janë të barabartë.

Veprimtari praktike: Nxënësit reflektojnë me shkrim për veprimin e Herës, për të mos u bërë pjesë e grupit.

Ata argumentojnë mendimin e tyre përpara grupit.

2. Përforcimi: Mësova!

Nxënësit nxjerrim mesazhe dhe i shkruajnë në kolonën e tretë. Ne jemi pjesë e grupit. Në grup kemi të drejta dhe përgjegjësi.

Vlerësimi: Përmbledhës për pyetjet, përgjigjet dhe argumentet

Detyrë: Listo grupet ku t’i bën pjesë.

Planifikim i orës mësimore 2.4

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Respekti ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve		Situata e te nxënit: Shembuj nga jeta e përditshme	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Vlerëson miqësinë dhe solidaritetin si vlera të bashkëjetesës në grup. Tregon raste të shkeljes së rregullave të mirësjelljes dhe diskuton pasojat e tyre për vete dhe grupin ku bën pjesë. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Tregon interes për nevojat e të tjerëve. Shfaq ndjenjën e përgjegjësisë vetjake në shtëpi, shkollë, shoqëri. Tregon gatishmëri për të ndihmuar dhe respektuar shokët, të moshuarit etj. 	
Fjalë kyçe: respekt, ndjenjë, mirëqenie, lëndo		Burimet: Teksti figura ilustruese	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Pesëvargësh-Lexim me fragmente-Lojë me role	

Organizimi i orës së mësimit:

1. Parashikimi –Pesëvargësh.

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve, të ndërtojnë një pesëvargësh me fjalën, *Respekt*.

2. Ndërtimi i njohurive.

Lexim me fragmente. Leximi i tekstit me fragmente i shoqëruar me komentim e figurave.

Shembulli 1: Portreti i themeluesit të shtetit Shqiptar Ismail Qemali, figurë e respektuar historike, admirohet nga brezat për kontributin e tij në themelimin e shtetit.

Shembulli 2: Ema ndihmon nëna Rozën të kalojë rrugën.

Shembulli 3: Në familje kur nuk zbatohet rregullat, prindërit na tërheqin vëmendjen, nxirren me nxënësit idetë kryesore: Të respektojmë veten dhe të tjerët. Të respektojmë më të rriturit. Të përdorim fjalë magjike e të jemi tolerantë.

Vepërtari: Në grupe katërshe, nxënësit lidhin etiketat në të majtë me përgjigjen e duhur në të djathtë. Shembulli: -Etiketa e parë majtas me etiketën e tretë djathtas.; Etiketa e dytë majtas me etiketën e katërt djathtas.; Etiketa e tretë majtas me etiketën e fundit djathtas. Çdo grup diskuton për zgjidhjen konkrete, ata sjellin shembuj nga jeta e përditshme dhe grupet ku bëjnë pjesë.

3. Përforsimi: Lojë me role.

Nxënësit ndahen në grupe duke sjellë raste të sjelljes së mirë dhe jo të mirë nga jeta e përditshme.

Vlerësimi: Vlerësimi nxënësve për identifikimin e sjelljeve të mira dhe krijimin e situatave në grup.

Detyrë: Shkruaj tri fjalë të urta për respektin.

Planifikim i orës mësimore 2.5.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Miqësia është e rëndësishme		Situata e të nxënit: Lojë	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan disa nga cilësitë që duhet të ketë shoku, të cilat ushqejnë miqësinë e solidaritetin dhe forcojnë grupin. • Vlerëson miqësinë dhe solidaritetin si vlera të bashkëjetesës në grup. 		<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregojnë interes për nevojat e të tjerëve. • Shfaq përgjegjësi për respektim të miqësisë. • Luan në grupe sipas rregullave. 	
Fjalë kyçe: pasojë, i përgjegjshëm		Burimet: Teksti, figura ilustruese	

<p>Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Dramatizim</p>	<p>Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Stuhi mendimesh, Vëzhgo-diskuto-Lojë me role</p>
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>1. Parashikimi: Stuhi mendimesh. Mësuesi/ja shkruan në qendër të tabelës fjalën e përgjegjshëm dhe nxit nxënësit të japin mendime rreth fjalës. Pranoen mendimet e tyre dhe mësuesi/ja shton se i përgjegjshëm do të thotë të mendohesh përpara se të veprosh apo të flasësh. Në këtë mënyrë nuk lëndon ato që ke pranë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Vëzhgo-diskuto. Hapen librat në faqen 30, leximi i tekstit dhe nxjerrja e përgjegjësi dhe pasojave kur nuk mendon, mendon përpara se të veprosh. Kur bën veprime të pamenduara ti lëndon prindërit, shokët, mësuesin/en, por edhe veten sepse mbetesh jashtë grupit. Prandaj duhet të mendohemi përpara çdo veprimi. Kështu forcojnë mirësinë dhe respektin ndaj vetes.</p> <p>Veprimtari: Në grupe katërshe.</p> <p>Figura 1. Vajza ka humbur rrugën. Si mendon të dalë nga situata? Si do t'i drejtohesh atyre që ke pranë për ndihmë?</p> <p>Figura 2. Kujt i drejtohesh për ndihmë në një situatë të tillë? Mendon se miku do të ndihmojë?</p> <p>Figura 3. Nuk e di zgjidhjen e ushtrimit. Kërkon ta kopjosh apo kërkon ndihmë për të ta shpjeguar? Cila do të ishte rruga më e drejtë?</p> <p>Figura 4. Je duke mësuar biçikletën ose ndonjë lojë tjetër. U kërkon ndihmë miqve apo e zgjidh vetë? I vë shokët në lojë kur janë në vështirësi? Pse? Nxënësit reflektojnë me shkrim për situatën në tekst dhe argumentojnë përgjigjet.</p> <p>3. Lojë me role: Nxënësit ndahen në grupe dhe luajnë me role, situatë e ngjashme si në faqen 31. Ata përdorin fjalë magjike, tregojnë shkaqet dhe pasojat e çdo veprimi të papërgjegjshëm ndaj njëri-tjetrit.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen për dhënien e ideve, argumenteve e komentet ndaj situatave të ngjashme, vlerësohen për fjalorin e gjuhën e përdorur me njëri-tjetrin.</p> <p>Detyrë: Shkruaj dy fjalë të urta për miqësinë.</p>	

Planifikim i orës mësimore 2.6

<p>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</p>	<p>Lënda: Edukim për shoqërinë</p>	<p>Shkalla: II</p>	<p>Klasa: III</p>
<p>Tema mësimore: Luaj dhe mësoj, shok i mirë</p>		<p>Situata e të nxënit: Lojë</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vendos përparësi ndërmjet interesave të përbashkëta dhe dallimeve që ekzistojnë në një grup. Menaxhon emocionet, ndjenjat gjatë kryerjes së lojërave. 		<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> Emërton rregulla, për një lojë të caktuar (3-4 rregulla). Luan duke zbatuar rregullat. 	

Fjalë kyçe: shkallinë, u nxeh, patericë, qytetari, durim	Burimet: Teksti, loja e vizatuar në karton, zare (me numër 1 deri në 6), shirita letre, lapustila
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Matematikë	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Diskutim paraprak, Lojë në grupe, Shkrim i lirë
<p>Organizimi i orës së mësimit:</p> <p>1. Parashikimi: Diskutim paraprak. Mësuesi/ja zgjon interesin e nxënësve rreth temës: -A e keni luajtur ndonjëherë lojën “Mos u nxeh”? “A e dini ç’kuptim ka?” Loja kërkon të ruash qetësinë, të pranosh humbjen njësoj si fitoren, të respektosh shokun dhe t’i shkosh deri në fund lojës.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Lojë në grupe. Mësuesi/ja ka përgatitur me nxënësit në orën e artit pamor, lojën në një karton.</p> <p>Veprimtari: Nxënësit ndahen në grupe katërshe. Mësuesi/ja ndjek udhëzimet për përshkrimin e hapave të lojës. Nxënësit mësojnë disa prej rregullave që duhet të ndjekin.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Respekto shokët në lojë. • Loja luhet deri në fund. • Mos u nxeh kur je humbës. • Prano me qytetari fitoren e shokut. • Mos e vë në lojë shokun që humb. <p>Gjatë lojës nxënësit marrin mesazhe të fuqishme në lidhje me miqësinë.</p> <p>3. Përfundim: Shkrim i lirë. Secili grup pasi ka përfunduar lojën shkruan në shirita letre një mesazh që ka nxjerrë gjatë lojës. Mesazhet vendosen në formë shkalline në ambientet e klasës, në mënyrë që nxënësit t’i zbatojnë në aktivitetet e ndryshme gjatë jetës shkollore.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për mendimet dhe opinionet e shprehura, lojën, mesazhet e përcjella.</p> <p>Detyrë: Shpërndaj eksperiencën e lojës tende me miqtë në komunitet.</p>	

Planifikim i orës mësimore 2.7

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Aktivitet: Vlerësojmë miqësinë		Situata e të nxënësve: Ndërvepruese	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon një projekt në grup në lidhje me temën. • Shpreh mendimin e tij me gojë ose shkrim. 		<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon raste të ndihmës ndaj njëri-tjetrit. • Tregon përvoja personale sfidash. 	

Fjalë kyçe: sfidë, pasojë, përgjegjësi, sekret	Burimet: Teksti, Shirita, Rrjetë, Kosh
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Parashikim nëpërmjet titullit, Veprimtari me grupe - Turi i Galerisë
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>1. Parashikimi: Parashikimi nëpërmjet titullit. Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin dhe nxit nxënësit nëpërmjet saj të shprehën. Dëgjohen komentet e nxënësve.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Veprimtari me grupe. Mësuesi/ja shpjegon fjalët kyçe dhe ndalet te fjala sfidë. Ajo tregon se sfida është thirrje që i bëhet dikujt për të hyrë në garë, për të realizuar një detyrë, pra për t’ia dalë mbanë.</p> <p>Ai/ajo fton nxënësit të ndahen në grupe. Ata duhet të përgatiten për sfida, që nuk janë të lehta për t’u realizuar.</p> <p>Vërehet figura e tekstit fq. 34. Eri fton shokët në sfidën e miqësisë, secili të përgatiten për sfidë.</p> <p>Nxënësit në shirita shkruajnë një sfidë që duhet ta realizojnë brenda një muaji.</p> <p>Shembull:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të ndihmojë Arbrin të studiojë gjuhë të huaj. • Do të ndihmojë Borën të mësojë ushtrime me rreth gjimnastikor (Shembuj të ngjashëm ka në tekst). <p>Sfidat e shkruara në fisha futen në kosh ose rrjete. Mësuesi/ja pasi i përzier fton nxënësit të tërheqin një shirit, secili lexon sfidën pa ia treguar tjetrit. Mbas 1 muaji sjellin përvojën e realizimit të sfidës.</p> <p>Veprimtari: Nxënësit ndahen në grupe, grupet 1 dhe 2 presin shirita në letra me ngjyra, si tregues të figurave në ushtrimin 2. Në çdo shirit shkruajnë një fjalë ose fjali për miqësinë. Më pas i bashkojnë në vargje, grupi 3 dhe 4 përgatisin kurora me pëllëmbët e duarve të prera në letër më ngjyrë. Nxënësit kanë shkruar cilësi të shokut apo shoqes më të mirë. Kështu formohen vargje e kurora miqësie.</p> <p>3. Përforsim:Turi i Galerisë: Nxënësit vëzhgojnë dhe lexojnë mesazhet e miqësisë, të krijuara në këndin e miqësisë së mirë.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në veprimtari aftësi të tyre rrëfyese, mendimet e ndarjen e përvojave të miqësisë së mirë.</p> <p>Detyrë: Përgatit një kartolinë për mikun, miken.</p>	

Planifikim i orës mësimore 3.1

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	L ë n d a : Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
------------------------------------	--	--------------------	-------------------

Tema mësimore: Unë jetoj këtu	Situata e te nxënit: Pamje me foto ose videoprojektor të zonave të banuara.
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon një zonë të banuar si vendi ku njerëzit jetojnë, punojnë, luajnë, shkollohen. • Shpjegon qartë dhe saktë me gojë ose shkrim kuptimin e termave, fjalive, koncepteve në lidhje me temën. 	Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Dallon komunitetin, si grup njerëzish me interesa të përbashkët. • Shpjegon organizimin e jetesës në komunitetin e tij.
Fjalë kyçe: Komunitet, fqinj, qytetar, popullatë	Burimet: Figura ilustruese, foto, CD, Video Projektor, Kartolina, Harta e Shqipërisë
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Të nxënit bashkëveprues
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Lapsat në mes. Mësuesi/ja i vendos nxënësit në grupe dhe u kërkon të tregojnë në lagjen ku banojnë. Nxënësi që është gati për përgjigje vendos një laps në mes. Mësuesi/ja kalon në çdo grup dhe kap një laps. Përgjigjet nxënësi i cili ka lapsin e vet. Mësuesi/ja liston disa nga përgjigjet në tabelë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Veprimtaria e të menduarit të drejtuar. Mësuesi/ja fton nxënësit të hapin librat, komentohen figurat, mësuesi/ja çon nxënësit në përfundimet rreth figurës 1. Zonë e banuar buzë detit (qytet ose fshat bregdetar). Tregohen në hartën e Shqipërisë disa të tilla. Figura 2. Zonë e banuar mes malesh, zonë malore. Figura 3. Zonë e banuar në qytet. Figura 4. Qytet i vogël me rrugë të ngushta e shtëpi karakteristike. Për çdo figurë mësuesi/ja konkretizon me shembuj në hartën e Shqipërisë. Ai/ajo tregon foto, kartolina për video projektor. Mësuesi/ja lexon më ndalesa dhe shpjegon konceptet kryesore; “Komunitet” – grup njerëzish që jetojnë në të njëjtin vend. duke respektuar rregullat. “Qytetare” – të gjithë ata që jetojnë në një zonë të banuar, duke respektuar ligjet dhe rregullat brenda Komunitetit.</p>	
<p>Veprimtari: Veprimtari në dyshe punim i faqes 39, nxënësit në dyshe plotësojnë pemën e mendimit për komunitetet e tyre ato përshkruajnë elementet e veçantë që ka Komuniteti përveç shtëpive të banimit. Nxënësit nxjerrin përfundimet e përafërta me njëri-tjetrin.</p> <p>3. Përforcim: Diskutim dhe shkëmbim i përvojave në dyshe.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për mendimet dhe opinionet e shprehura, komentet dhe përshkrimet e komuniteteve të tyre.</p>	

Planifikim i orës mësimore 3.2

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Njerëzit në komunitetin tim		Situata e te nxënit: Përvoja nga jeta në komunitet	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizo një zonë të banuar si vendin ku njerëzit jetojnë, punojnë, luajnë, shkollohen. • Ndërlidh temën e re me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Flet për anëtarët e Komunitetit të tij. • Përshkruan një Komunitet në qytet me atë të fshatit. 	
Fjalë kyçe: Apartament, qytet, fshat, anëtarë		Burimet: Figura ilustruese, foto, CD, Video Projektor, grafikë	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësit: Të nxënit bashkëveprues	
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Stuhi mendimesh. Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë për jetën në komunitetin e tyre, shtëpi të banimit, dyqanet, shërbimet, shkollat, parqet e të tjera. Mësuesi/ja paraqet fotot ose shfaq në projektor jetën në komunitete, fshat ose qytet.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Të nxënit në bashkëpunim. Mësuesi/ja prezanton përpara nxënësve përbërjen e komunitetit dhe larmishmërinë. Banorët janë anëtarët që e përbëjnë atë. Ata vijnë nga kultura të ndryshme, kanë profesione, interesa dhe tradita të ndryshme. Por i bashkon jetesa në një komunitet, rrugë apo zonë banimi. Komuniteti ka variante të ndryshme banesash (nxënësit krahasojnë shtëpitë e tyre). Komuniteti ka qendra banimi në dobi të anëtarëve të saj; dyqane, parqe. Në fshat, shtëpitë janë 1, 2, trekatëshe, larg njëra-tjetrës me rrugë të ngushta e pak të shtruara. Veprimtari: Nxënësit punojnë grafikun në faqen. 41. Ata përkufizojnë me fjalët e tyre qytetin dhe fshatin. Qyteti është qendër e madhe banimi ku zhvillojnë veprimtarinë e tyre një varg institucionesh politike, shoqërore, administrative, ndërmarrje, qendra tregtare. Karakteristika të qytetit: qytet i vogël, i madh, turistik, i vjetër... Fshati qendër e vogël banimi ku njerëzit merren me bujqësi, blegtori dhe përpunimin e tyre. Fshatrat janë fushorë, malorë, turistikë, bregdetar etj. Emërtohen, tregohen foto të ndryshme.</p> <p>3. Përforsim: Turi i Galerisë. Ekspozohen ilustrimet e fshatrave dhe qyteteve. Nxënësit shpjegojnë ilustrimet.</p>			

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për argumentet dhe përvojat personale, krahasimet dhe ilustrimin e Komuniteteve.

Detyrë: Vizato komunitetin ku jeton.

Planifikim i orës mësimore 3.3

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Komuniteti është yni		Situata e te nxënit: Diskutim për foto dhe postera të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Dallon disa nga institucionet të ofrojnë shërbime për Komunitetin ku jetojnë. Përshkruajnë disa nga veprimet që janë të domosdoshme për të shfrytëzuar shërbimet e komunitetit ku jeton. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Identifikoi shërbimet e domosdoshme në komunitet. Argumentoi funksionin e tyre në komunitet. 	
Fjalë kyçe: përgjegjësi, bashkëpunim, vullnetar, biznes		Burimet: figura ilustruese, teksti, fletë A4	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Lapsat në mes, lexim me fragmente, shkrim i lirë	
Organizimi i orës së mësim: <p>1. Parashikimi: Lapsat në mes: Mësuesi/ja njeht nxënësit me temën. Në grupe me nga 4, ata mendohen e vendosin lapsin në mes të tryezës kur kanë gati përgjigjet. Nxënësit që nuk kanë informacion vendosin duke thënë “Pas”.</p> <p>Nxënësit i japin informacionin që dinë, mësuesi/ja liston disa prej tyre.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Lexim me fragmente. Hapen librat. Nxënësit lexojnë në dyshe me fragmente pjesën dhe diskutojnë për shërbimet që ofron komuniteti nëpërmjet figurave. Jepen shërbimet komunitare që ofrohen.</p> <p>Mësuesi/ja mund të sigurojë në klasë një bisedë me mjekun e familjes, një punonjës rendi, hidraulik, veteriner rrobaqepës (Mund të jenë prindër të nxënësve me këto profesione).</p> <p>Veprimtari: Nxënësit përshkruajnë në dy diagrame profesionet e mësuesit dhe mjekut. Mund të shtojnë në fletë A4 edhe diagrame për profesione të tjera komunitare në ilustrim.</p> <p>3. Përforcim: Shkrim i lirë. Nxënësit përshkruajnë me shkrim profesionin e preferuar dhe e ilustron atë.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për argumentet dhe përvojat personale, krahasimet dhe ilustrimin e profesioneve të ndryshme.</p> <p>Detyrë: Shkruaj disa shërbime që kryhen në komunitetin tënd.</p>			

Planifikim i orës mësimore 3.4

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Veprimtaritë në komunitet		Situata e të nxënit: Veprimtari praktike për shërbimet në komunitet.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë disa nga veprimet që janë të domosdoshme, për të shfrytëzuar shërbimet e komunitetit ku jeton. • Bashkëvepron në grup, duke menaxhuar emocionet, ndjenjat gjatë veprimtarive. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Tregon shërbimet që ofrohen në komunitetin e tij. • Argumenton rolin e tyre për qytetarët. 	
Fjalë kyçe: Fqinj, Rikonstruksion, Bord i Shkollës, Shërbim Postar		Burimet: Figura ilustruese, teksti, grafikë	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Metoda gjithëpërfshirëse	
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Dil rrotull, fol rrotull. Mësuesi/ja drejton pyetjen: “Çfarë veprimesh kryeni ju në Komunitet?” “Kujt i drejtoheni për të blerë, për të postuar një letër?” Mësuesi/ja mirëpret çdo përgjigje të nxënësve dhe liston disa prej shërbimeve në tabelë.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Përvijim i të menduarit. Hapen librat në faqen 44. Lexohet pjesa në paragrafë dhe diskutohet në dyshe. Mësuesi/ja drejton nxënësit nga figurat. Aty pasqyrohen shumë shërbime në komunitet. Nënvizohet fakti që në komunitet, njerëzit plotësojnë nevojat e tyre, mësuesi/ja shpjegon fjalën rikonstruksion (riparime, rregullime që i bëhen çerdheve, kopshteve, shkollave etj.); bordi i shkollës (grup njerëzish që drejtojnë punën dhe veprimtaritë për mirëmbajtjen e shkollës, i përbërë nga mësues dhe prindër).</p> <p>Veprimtari: Punim i ushtrimit 1, faqe 45. Për secilën fjalë, nxënësit vëzhgojnë grafikun dhe plotësojnë me (Tick) përgjigjen e saktë.</p> <p>3. Përforcim: Punë individuale. Nxënësit ngjyrosin me ngjyra të ndryshme shërbimet që janë aktive në komunitetin e tyre. Ato sjellin shembuj me gojë, të rasteve kur janë drejtuar atje për shërbime.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për argumentet dhe përvojat personale, veprimtaritë që kanë kryer në komunitet, fjalorin dhe gjuhën e përdorur në lidhje me temën.</p> <p>Detyrë: Trego një rast që të është ofruar ndihmë në komunitet.</p>			

Planifikim i orës mësimore 3.5

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qeverisja vendore		Situata e te nxënit: Diskutime rreth shërbimeve e punëve në komunitet.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Dallon disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime në komunitetin ku jetojnë. Tregon se çfarë mund dhe duhet të bëjnë fëmijët dhe banorët e tjerë në komunitet, për te rritur cilësinë e shërbimeve. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Emërton 2, 3 institucione lokale në shërbim të tij. Tregon rolin e Bashkive dhe Komunave në shërbim të banorëve. Diskuton për probleme të dukshme të mirëmbajtjes në komunitet. 	
Fjalë kyçe: Qeverisje, taksa, Komunë, Bashki		Burimet: teksti, foto	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Di, dua të di, mësova	
Organizimi i orës së mësim: <p>1. Parashikimi: Di. Nxënësit njihen me temën dhe plotësojnë kolonën Di, për ato që dinë rreth saj. Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet për disa minuta.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Dua të di. Lexohet nderi në faqen 46. Nxënësit bëjnë pyetje për që duan të dinë. Disa pyetje mund të jenë: “Kush i harton ligjet?” “Cili drejton punën dhe kontrollon zbatimin e ligjeve në Komunitet?” “Ç’rol ka shteti?” Mësuesi/ja jep informacion në lidhje me Bashkinë, organ bazë i një qyteti, i cili drejton punët publike. Ai/a jo mbulon drejtimin përmes punonjësve të tij, që quhen punonjës bashkiake. Bashkia ka një këshill drejtues të zgjedhur me votat e qytetarëve. Në fshat, kjo njihet si Komunë dhe ka të njëjtat funksione. Veprimtari: Mësuesi/ja fton nxënësit të mendojnë së bashku për zgjidhjen e një problemi në komunitet. Për shembull: Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta pranë vendbanimit të tyre. Nxënësit mund të ndihmojnë duke sensibilizuar banorët për të kontribuar. Për këtë do të përgatiten fletëpalosje. Situata hidhet për votim. Mësuesi/ja i orienton nxënësit drejt mënyrës së votimit dhe rolit të saj. Kështu votohet edhe në këshillin bashkiak.</p> <p>3. Përforsim: Mësova. Nxënësit reflektojnë për zgjedhjet në grup. Ata kontribuojnë në pastrimin e mjediseve rreth shkollës. Ky është konkluzioni i rolit të banorëve në çdo komunitet. Pra çdo qytetarë është pjesë e komunitetit dhe jep ndihmën e tij në dobi të qytetit.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve për emërtimin e institucioneve lokale, rolin dhe shërbimet që ato ofrojnë dhe kontributin e qytetarëve.</p> <p>Detyrë: Sillni shembuj të një veprimtarie në komunitetin tuaj.</p>			

Planifikim i orës mësimore 3.6

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Luaj dhe mësoj: Komuniteti im		Situata e të nxënimit: Situatë loje	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor), për të kryer lojën. • Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, gjatë kryerjes së lojës në grup. 		Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Mësojë rregullat e lojës. • Zbatoi njohuritë për shërbimet në komunitet në lojë. • Luan, duke treguar maturi në marrëdhëniet në grup. 	
Fjalë kyçe: Lojë, rregulla, zare, bukëpjekës, stadium		Burimet: teksti, grafiku lojës, zare	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Metoda gjithëpërfshirëse	
Organizimi i orës së mësimimit: <p>1. Parashikimi: Diskutimi paraprak. Mësuesi/ja nxit nxënësit të vërejnë grafik loje. Ajo çon në diskutim rreth figurave. Figurat përfshijnë shërbime komunitare. Si do të luhet?</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Lojë: Mësuesi/ja orienton nxënësit rreth lojës. Ai/ajo shpjegon se grupet do të jenë të ndarë në katërshe. Secili lojtar ka simbolin e tij. Shembull: 1, 2, 3, 4... Numri 1 hedh zarin dhe lëviz aq kuti sa shënon numri. Ndalea bëhet në kutizë dhe lexohet shënimi. Lojtari shkon në shërbimin që e orienton shënimi. Në rast se lojtarët bien në të njëjtën kuti, personi dytë ndërron vendet me të parin, kështu i pari kthehet te kutia fillestare. Nxënësit duhet të ruajnë qetësinë deri në fund të lojës.</p> <p>Veprimtari: Në grupe katërshe luhet loja sipas rregullave të mësipërme. Mësuesi/ja vëzhgon grupet gjatë aktivitetit.</p> <p>3. Përforcim: Diskutim rreth lojës, shërbimeve komunitare që hasen aty dhe vlerat e tyre.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për organizimin në lojë, zbatimin e rregullave e tolerancën e treguar.</p> <p>Detyre: Luaj lojën me shokët në komunitet.</p>			

Planifikim i orës mësimore 3.7

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
------------------------------------	------------------------------------	--------------------	-------------------

Tema mësimore: Veprimtari: Ndërtojmë së bashku komunitetin tonë	Situata e të nxënit: Situata: Veprimtari praktike për ndërtimin e një komuniteti.
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti për komunitetin. • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët e të tjerët. 	Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përgatit me materiale të riciklueshme pjesë të komunitetit. • Argumenton me gojë funksionet e tyre .
Fjalë kyçe: Maket, Materiale të riciklueshme	Burimet: Kuti kartoni të përmasave të ndryshme, shishe plastike, Puzzle, Lodra të vogla nga (Kinder), Plastelinë, Lule fushe, letra me ngjyrë, gërshtë, plastelinë, ngjites.
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Mësimdhënie e drejtpërdrejtë
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Mësuesi/ja organizon një stuhi mendimesh (Brainstorming) për të listuar shërbimet në komunitet.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Nxënësit njihen me qëllimin e temës. Ndahen në grupe me nga katër dhe zgjedhin një shërbim që ofron komuniteti, për ta ndërtuar me materiale të ndryshme.</p> <p>Veprimtari: Dy grupe përdorin kuti kartoni për zonën e banuar. Grupi i tretë ndërton Bashkinë ose Komunën, grupi i katërt poliklinikën, grupi 5 shkollën, kopshtin, grupi 6 terrenin sportiv, parkun, grupi 7 ndërton semaforët dhe sipërfaqen e gjelbëruar. Në ndihmë i vijnë Puzzle e lodra e të tjera, bashkohen elementet në një kënd të klasës dhe formohet maketi.</p> <p>Nxënësit vendosin dhe adresat e shtëpive e rrugëve të tyre.</p> <p>3. Përforcim: Nxënësit përshkruajnë me gojë komunitetin dhe shërbimet Komunitare të krijuara prej tyre.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për organizimin me grupe ndërtimin e maketëve dhe përdorimin estetikisht të materialeve të ndryshme.</p>	

Planifikim i orës mësimore 4.1

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Unë jam i përgjegjshëm në rrugë		Situata e të nxënit: Përvoja nga jeta për sigurinë në rrugë	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra në lidhje me temën, drejton pyetje, jep sqarime dhe propozime. • Dallon rreziqe dhe pengesa që mund të ndeshin kalimtarët dhe argumenton përpara grupit. 	<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërton 4 ose 5 rregulla të qarkullimit në rrugë. • Diskuton për rëndësinë e zbatimit të tyre.
<p>Fjalë kyçe: Kod rrugor, sinjalistikë, rregulla të qarkullimit rrugor</p>	<p>Burimet: Kod rrugor, tabela e shenja rrugore, teksti i nxënësit</p>
<p>Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte</p>	<p>Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Parashikim nëpërmjet titullit, Vëzhgo–mendo–diskuto–lojë me role</p>
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Parashikim nëpërmjet titullit. Mësuesi/ja shkruan titullin në tabelë. Nxit nxënësit të tregojnë sa i zbatojnë rregullat e ecjes në rrugë, çfarë tabelash dhe shenjash rrugore njohin...</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Vëzhgo-Mendo-Diskuto. Hapen librat nxënësit në dyshe vëzhgojnë figurat dhe komentojnë. Figura 1. Fëmijë që ecin në trotuare (trotuare me bordure për të ndaluar parkimin e automjeteve). A ka në trotuarin pranë shkollës suaj bordurë mbrojtëse? Figura 2. Kalimtarët ecin të sigurtë në vijat e bardha. Figura 3. Mbikalimi shërben për ecjen e këmbësorëve ku rruga është me dy korsi dhe trafik ndarëse. Figura 4. Rruga e vijëzuar ndarje për makinat dhe biçikletat. Mësuesi/ja i mëson disa prej rregullave bazë të ecjes në rrugë.</p> <p>Veprimtari: Nxënësit në grupe katërshe krijojnë një histori me elementet e dhëna në tekst, për shembull, tema “Rreziku në rrugë para shkollës”. Problemi: Mungojnë vijat e bardha. Mundësitë: Kërkohet ndihma e punonjësve të bashkisë. Personazhet: Andi, Bora, Drini, Dita. Zgjidhja: Bashkëpunimi me prindërit e punonjësit e bashkisë për vijëzimin e rrugës. Nxënësit e shpjegojnë me shkrim historinë.</p> <p>3. Përforcim:</p> <p>Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për fjalorin e përdorur, përshkrimin, opinionet dhe zgjidhjen e situatave në rrugë.</p> <p>Detyrë: Krijo një skemë më historinë tënde me një tematikë të caktuar.</p>	

Planifikim i orës mësimore 4.2

<p>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</p>	<p>Lënda: Edukim për shoqërinë</p>	<p>Shkalla: II</p>	<p>Klasa: III</p>
<p>Tema mësimore: Siguria varet dhe nga unë</p>		<p>Situata e të nxënit: Përvoja nga jeta e përditshme në qarkullimin në rrugë.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunon me të tjerët për të vendosur rregulla të reja kur është e nevojshme. • Përdor si duhet atë pjesë të fjalorit rrugor që lidhet me të, si përdorues rruge. 	<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon rreziqet të mundshme në rrugë. • Respekton rregullat e sigurisë rrugore.
<p>Fjalë kyçe: Këmbësor, trafik</p>	<p>Burimet: Kod rrugor, tabela e shenja rrugore, teksti i nxënësit</p>
<p>Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte</p>	<p>Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Metoda gjithëpërfshirëse</p>
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Mësuesi/ja diskuton me nxënësit, për disa prej rregullave që ata njohin për ecjen në rrugë. Ai/jo fton nxënësit të vërejnë figurat në tekst. Diskutimi përqendrohet në tri veprime kryesore që duhet të bëjnë në rrugë këmbësorët e veçanërisht fëmijët: 1. Ndalo 2. Shiko 3. Dëgjo.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Mësuesi/ja shpjegon konceptet kyçe të mësim. Ai/a jo orienton nxënësit të përdorin termat: Këmbësor, Trotuar, Trafik. Në rastet kur në rrugë ka shumë makina, ne themi se ka trafik dhe këmbësorët (qytetarët që ecin në këmbë) duhet të ecin në trotuar. Kur nuk ka trotuar ecet në anën e majtë të rrugës, anë në të cilën fushëpamja është më e orientuar për t'i shmangur rreziqet. Veprimtari: Punim i ushtrimit faqe 57. Në ushtrimin 1, nxënësit vërejnë figurën dhe përgjigjen me shkrim. Fëmija ka ndaluar në trotuar dhe pret të kalojnë makinat. Ushtrimi 2. Nxënësit formojnë grupe katërshe dhe përshkruajnë një sjellje të papërgjegjshme, duke nxjerrë shkakun dhe pasojat. Shembull: Blini po luan me top në rrugë. Ai nuk e ka mendjen dhe rrezikohet nga makinat...</p> <p>3. Përforsim: Nxënësit shkruajnë në fisha një mesazh për sigurinë në rrugë. I këmbëjnë me njëri-tjetrin dhe i lexojnë. Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për fjalorin e përdorur përshkrimin, opinionet dhe zgjidhjen e situatave në rrugë. Detyrë: Ilustro një sjellje të denjë në rrugë si këmbësorë.</p>	

Planifikim i orës mësimore 4.3

<p>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</p>	<p>Lënda: Edukim për shoqërinë</p>	<p>Shkalla: II</p>	<p>Klasa: III</p>
<p>Tema mësimore: Rruga është e të gjithëve</p>		<p>Situata e të nxënit: Situata në foto ose video projektor të rrugëve të ndryshme.</p>	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar. • Përdor si duhet atë pjesë të fjalorit të trafikut që lidhet më të si përdorues rruge. 	<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikoi të paktën 3-4 lloje rrugësh. • Respekton rregullat në çdo fushë të veprimit.
<p>Fjalë kyçe: Këmbësor, pistë biçikletash</p>	<p>Burimet: Kod rrugor, tabela e shenja rrugore, teksti i nxënësit, projektor, zare, fisha</p>
<p>Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Matematikë</p>	<p>Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Mësimdhënie e drejtpërdrejtë</p>
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Vëzhgo-Mendo-Diskuto. Mësuesi/ja paraqet një plan të rrugëve në projektor ose foto. Nxënësit vëzhgojnë dhe diskutojnë për llojet e rrugëve, mësuesi/ja shpjegon se rrugët janë të larmishme dhe si të tilla kanë emërtimet e veta.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Të nxënit në bashkëpunim. Mësuesi/ja shpjegon skemën e rrugës në faqen 58. Mirë është që ajo të jetë e zmadhuar (në formë posteri) ose në projektor. Jepen lloje rrugësh, emërtime dhe fjalor i saj. Rrugët brenda qytetit janë urbane, rrugët që lidhin qytetet me njëra-tjetrën quhen ndërurbane. Kemi rrugë rurale, të cilat lidhin fshatrat njëri me tjetrin.</p> <p>Veprimtari: Nxënësit në dyshe luajnë me zare. Nxënësi hedh dy zare dhe mbledh numrat. Shembull: 6 dhe 4 = 10 pjesëtohet me 2 = 5, more 5, shko te përgjigjja që shënon 5. Do të ngjyrosësh vijat e bardha. Në qoftë se gjatë veprimeve me zare nuk merr asnjë numër, për shembull: $6 + 3 = 9 : 2 = \dots$ lojtari humb radhën. Mësuesi/ja vëzhgon lojën në dyshe.</p> <p>3. Përforsim: Shkrim i lirë. Shkruaj në fisha lloje rrugësh (trotuar, krosi) dhe krijo me to murin e shenjave rrugore në klasën tënde. Këmbe mendimet me shokët.</p> <p>Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për fjalorin e përdorur, përshkrimin, opinionet dhe lojën në dyshe.</p> <p>Detyrë: Luaj në komunitet me shokët/shoqet lojën e rregullave rrugore.</p>	

Planifikim i orës mësimore 4.4

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Sinjalet në rrugë		Situata e të nxënit: Vëzhgim në rrugë i sinjalsitikës rrugore	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përdor fjalorin e duhur në lidhje me temën. • Bashkëpunon në grup për zbatimin e rregullave rrugore. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon 4-format e sinjalistikës rrugore. • Argumenton rëndësinë e përdorimit të tyre. 	
Fjalë kyçe: Sinjal, sinjalistikë, vertikal, horizontal, manual		Burimet: Figura ilustruese, tabela e manual rrugore	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënës: Metoda gjithëpërfshirëse	
Organizimi i orës së mësim: <p>1. Parashikimi: Diskutim paraprak. Mësuesi/ja iu tregon nxënësve për sinjalistikën rrugore si formë themelore e komunikimit në rrugë. Ai/ajo i prezanton me foto 4 grupet bazë. 1. Me ndriçim (Semaforët) 2. Manuale (Shërbimi që na jep Polici rrugor) 3. Tabelat e vendosura në shtylla (Sinjalistikë vertikale) 4. Vijat e bardha (vizatime në rrugë) Sinjalistikë horizontale.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Vëzhgo–mendo–diskuto. Mësuesi/ja e vazhdon pjesën tjetër të mësimin në rrugën përpara shkollës. Ai/ajo u kërkon nxënësve të identifikojnë sinjalistikat që vërejnë. Veprimtari: Nxënësit në skemën vizatojnë sinjalistika rrugore, që mësuan nga vëzhgimet dhe teksti.</p> <p>3. Përforsim: Diskutim. Secili nxënës shpjegon përpara shokëve llojet e sinjalistikave që ka përdorur. Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për argumentet, vëzhgimet, vizatimet dhe fjalorin e përdorur në lidhje me Kodin Rrugor. Detyrë: Vizato në skeme 4 sinjalistikat kryesore rrugore.</p>			

Planifikim i orës mësimore 4.5

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Unë bëj zgjedhjet e duhura		Situata e të nxënit: Diskutime rreth rreziqeve të mundshme në rrugë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> Parashtron disa nga rreziqet e mundshme të sigurisë në rrugë. Ndërlidh temën e re me njohuri e përvoja paraprake. 		Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Përcakton rreziqe të mundshme në rrugë. Argumenton shkaqet dhe pasojat e veprimeve të pasigurta në rrugë. 	
Fjalë kyçe: rrezik , pasojë ,rrezik i dukshëm		Burimet: Figura ilustruese, tabela e manual rrugore	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Metoda gjithëpërfshirëse	
Organizimi i orës së mëimit: <ol style="list-style-type: none"> Parashikimi: Stuhi mendimesh (Brainstorming). Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të japin mendimin e tyre me fjalën RREZIK. Shkruhen, mendimet e nxënësve në tabelë. Ndërtimi i njohurive: Përvijim i të menduarit. Hapen librat në faqen 62. Ftohen nxënësit të komentojnë, figurat dhe të diskutojnë për rreziqe të mundshme në rrugë. Mësuesi/ja jep fakte e argumente për rreziqe të mundshme. <ol style="list-style-type: none"> Rrezik kur ecën në rrugën e makinave pa respektuar rregulla. Veprimtari: Ushtrimi 1, faqe 63. Komentohej figura. Rreziku që të vjen nga përdorimi i medikamenteve që t'i nuk i njuh ose i përdor pa dijeninë e prindërve. Jepen këshilla në mbrojtje të shëndetit nga përdorimi i sendeve që rrezikojnë shëndetin (bombol gazi, çakmak, shkrepe, medikamente mjete të mprehta etj.). <ol style="list-style-type: none"> Përforcim: Diskuto në grup. Nxënësit diskutojnë për situatën. Ata bëjnë zgjedhjen e tyre të luajnë me moshatarë apo me më të rritur. Argumentojmë përgjigjet, shkaqet dhe pasojat për zgjedhjen e gabuar. Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për argumentet, komentet, këshillat dhe opinionet në lidhje me situatat e tekstit. Detyre: Trego një rast kur je ndjerë i rrezikuar në rrugë.			

Planifikim i orës mësimore 4.6

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Luaj dhe mësoj: Lëviz i sigurt		Situata e të nxënët: Lojë për situata të sigurta e të pasigurta në rrugë.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • Përdor strategjitë e duhura gjatë lojës në grup. • Argumenton rreziqet dhe pengesat e ndryshme me të cilat ndeshen dhe mbrojtjen ndaj tyre. 		Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përcakton rreziqe të pranishme në mjedis. • Argumenton mbrojtjen ndaj rreziqeve. 	
Fjalë kyçe: Shkak–pasojë, zgjedhje e sigurt, zgjedhje e pasigurt		Burimet: Zare, grafikë, harta	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Parashikim me terma paraprakë –Lojë –Diskutim	
<p>Organizimi i orës së mësim:</p> <p>1. Parashikimi: Parashikim me terma paraprakë. Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat: rrugë, zgjedhje e sigurt, zgjedhje e pasigurt, rrezik, siguri. Nxënësit plotësojnë me gojë një tekst sipas fantazisë.</p> <p>Mësuesi/ja plotëson se njeriu shpesh ndodhet në situata ose pengesa të vështira. Kur bën zgjedhje të duhura, je i sigurt. Kur bën zgjedhje të gabuar je i rrezikuar.</p> <p>2. Ndërtimi i njohurive: Prezantimi i lojës. Nxënësit luajnë në dyshë më zare. Hidhet zari dhe lëvizet aq sa kërkon numri. Kur ndalesa është në kutizën e kaltër, zgjidhja është e sigurt. Kur ndalesa është në kutinë e kuqe, zgjedhja është e pasigurt. Nxënësit mund të përgatisin edhe karta të tjera.</p> <p>3. Përforsim: Diskutojnë për kartat dhe zgjedhjet e sigurta, duke vënë në dukje shkaqet dhe pasojat, që vijnë nga zgjedhjet e pasigurta.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për lojën, qetësinë, komunikimin me njëri-tjetrin.</p> <p>Detyrë: Përgatit karta të tjera për lojën.</p>			

Planifikim i orës mësimore 4.7

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Veprimtaria: Ne jemi qytetarë të përgjegjshëm në rrugë		Situata e të nxënët: Si të sillemi në rrugë	

<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgatit një kënd për paraqitjen e shenjave rrugore. • Zhvillon një projekt në grup për kryerjen e një aktiviteti shoqëror me rëndësi për shkollën dhe komunitetin. 	<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallon sinjalistikën rrugore. • Argumenton rolin e tyre në qarkullimin rrugor.
Fjalë kyçe:	Burimet: Tabela, karat me ngjyrë, tapa shishesh, makina lodër, plastelinë, gërshtë
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Veprimtari praktike
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimi Vëzhgo-Mendo-Diskuto. Prezantimi i temës, vëzhgimi i figurave faqe 66. Nxënësit komentojnë tabelat dhe sinjalistikat. Mësuesi/ja mund ta zhvillojë këtë fazë të mësimi në rrugën përpara shkollës ose të ftojë një punonjës policie në klasë. 2. Ndërtimi i njohurive: Nxënësit përgatisin tabela me sinjalistika rrugore. Ndahen në grupe dhe punojnë me materiale të ndryshme. Përdorin edhe mjete të ndërtuara në orët të tjera mësimore të kapitullit. Sinjalistika rrugore i shtohet “Maketit të qytetit”, që nxënësit kanë përgatitur në kapitullin e tretë. 3. Përfundim: Ekspozimi i punëve të nxënësve dhe komenti e vëzhgimi edhe nga nxënës të tjerë të shkollës. <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin në grup, krijimin e sinjalistikës rrugore, gjuhën e përdorur dhe komunikimin.</p> <p>Detyrë: Zbato rregullat e qarkullimit në rrugë.</p>	

Planifikim i orës mësimore 5.1

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qyteti ynë një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe argëtohen.		Situata e të nxënësve: Diskutim, mbi filmin: “Qyteti më i ri në botë” ose dokumentarë apo foto qytetesh.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> • analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht; • zhvillon një projekt në grup, në lidhje me komunitetin dhe mjedisin që e rrethon. 		Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • dallon elementet përbërëse të qytetit; • përshkruan lidhjen mes bizneseve dhe zonave të qytetit. 	
Fjalë kyçe: Qytet, projekt, urbanist, zona industriale, zona bujqësore, zona biznesi.		Burimet: Materiale filmike, video projektor, fotografi, kartolina me pamje nga qytetet, karton bukëpeshku, kuti, shishe plastike, ngjitës, gërsërë.	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte.		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësve: Gjithëpërfshirëse	
<p>Organizimi i orës së mësimin:</p> <p>1- Parashikimi: Mësuesi prezanton temën përpara nxënësve në video projektor. Ai shfaq një film dokumentar për qytetin ose mund të shfaq filmin shqiptar për fëmijë “Qyteti më i ri në botë”. Në pamundësi mund të krijojë një pavijon në një kënd të klasës me pamje të ndryshme të qyteteve. Aty të përfshihen zonat e banuara, parqe, biznese, zona industriale, bujqësore etj.</p> <p>2- Ndërtimi i njohurive: Mësuesi bën komentet rreth pamjeve dhe nxit nxënësit për diskutime. Këshillohet që fjalët kyçe të kapitullit, mësuesi t’i ketë ekspozuar në muret e klasës, që nxënësit të familjarizohen me to. Këto terma të përvetësohen gjatë gjithë kapitullit, pa rënduar fëmijët. Mësuesi ndan nxënësit në grupe, nxënësit do të përgatitin me material të ndryshme zonat e qytetit; Zona banimi, zona industriale, zona bujqësore, zonë biznesi (me lodra të ndryshme) të sjella nga shtëpia. Grupi urbanistëve, që menaxhon situatën, duke skicuar dhe ndërtuar qytetin. Vendosen zonat e gjelbëruara, shkolla, shërbime.</p> <p>3- Përforsim: Secili grup prezanton elementet, bashkohen pjesët dhe formohet qyteti. Nxënësit shpjegojnë përpara grupeve rolin dhe funksionet e secilës pjese të qytetit.</p> <p>Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit në terminologjinë e përdorur, fjalorin, bashkëpunimin në grup dhe shpjegimin e formimit të qytetit dhe elementet përbërëse të tij.</p> <p>Detyrë</p>			

Planifikim i orës mësimore 5.2

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qyteti ynë, një vend ku njerëzit jetojnë, punojnë dhe argëtohen.		Situata e të nxënimit: Ekskursion nëpër qytet	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> shpreh mendimin e vet me gojë në lidhje me qytetin; parashtron pyetje dhe organizon mendimet e veta në lidhje me temën; bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët e të tjerët për realizimin e aktivitetit. 		Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> dallon elementet përbërëse të qytetit; përshkruan rolin dhe funksionin e zonave të ndryshme në qytet. 	
Fjalë kyçe: Qytet, projektoje, urbanist, zona industriale, zona bujqësore, zona biznesi.		Burimet:	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte.		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënimit: Gjithëpërfshirëse	
<p>Organizimi i orës së mësimimit:</p> <p>1- Parashikimi: Orën e dytë, mësuesi organizon një shëtitje me nxënësit nëpër qytet dhe zonat rreth tij. Kjo orë mund të jetë një bashkëpunim i mirë me bordin e prindërve, të cilët mund të sigurojnë transportin e fëmijëve nëpër qytet.</p> <p>2- Ndërtimi i njohurive: Mësuesi fton nxënësit të vëzhgojnë qytetin, rrugët, sheshet, ndërtesat qendër dhe periferinë e qytetit. Ai gjatë gjithë kohës do të jetë një guider shumë i aftë për t'u shpjeguar fëmijëve çdo fragment të qytetit. I përgjigjet me durim çdo pyetje që ata drejtojnë.</p> <p>3- Përforsim: Bashkë me nxënësit konsolidohen edhe një herë njohuritë për zonat e qytetit, terminologjinë që lidhet me temën. Vlerësimi: Përmbledhës për organizimin e qytetit. Detyrë</p>			

Planifikim i orës mësimore 5.3

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qyteti ynë një vend ku njerëzit shpenzojnë para.		Situata e të nxënimit: Veprimtari me grupe	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake; 		Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> identifikoi rolin e parasë në shoqëri; 	

<ul style="list-style-type: none"> bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, në një punë në grup. 	<ul style="list-style-type: none"> përcaktoi vlerën e taksave në dobi të komunitetit.
Fjalë kyçe: Të ardhura, para në dorë, çek, kartë debiti, taksa, taksë shitjeje.	Burimet: Teksti, figura ilustruese, kartëmonedha, fatura shitjeje, kartë debiti.
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Matematikë.	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësit: Gjithëpërfshirëse
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>1- Parashikimi: Njëpërmjet një stuhie mendimi rifreskohen njohuritë për qytetin, shërbimet që ofrohen.</p> <p>2- Ndërtimi i njohurive: Mësuesi shpjegon se qyteti është si një familje e madhe. Ai do mirëmbajtur, zgjeruar, do rrugë, parqe, kopshte, shkolla. Kush paguan për to? Mësuesi u shpjegon nxënësve si funksionon sigurimi i të hollave njëpërmjet taksave që paguajnë familjet, bizneset. Ai shpjegon taksat dhe taksën e shitjes, duke e demonstruar me fatura të ndryshme shitjesh. Njëpërmjet taksave mbushet arka e shtetit dhe të hollat shkojnë në dobi të qytetit. Tregohen kartëmonedha, karta debiti etj. Ushtrimet e faqes 71 punohen individualisht. Mësuesi ndan nxënësit në grupe dhe krijohen situata shitje-blerjeje në klasë. Grupi I në kancelari , Grupi II artikuj ushqimorë, Grupi III Dyqani i veshjeve. Nxënësit përgatisin bileta ose fatura për blerësit me taksë shitje, pagesat bëhen në forma të ndryshme.</p> <p>3- Përforsim: Diskutimi dhe konsolidimi i njohurive për mënyrën e funksionit të të ardhurave në qytet.</p> <p>Vlerësimi: Përmbledhës, për përdorimin e termave dhe bashkëpunimit në grup.</p> <p>Detyrë</p>	

Planifikim i orës mësimore 5.4

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qyteti ynë një vend ku njerëzit kryejnë veprime Bankare.		Situata e të nxënit: Ekskursion në një bankë të nivelit të dytë.	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake; bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, në një punë në grup. 		<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikon rolin e Bankës për qytetarin; menaxhon paratë personale. 	
Fjalë kyçe: Të ardhura, para në dorë, çek, kartë debiti, taksa, taksë shitje, bankë, institucion financiar, interes, depozita.		Burimet: Kartëmonedha, fatura shitjesh, kartë debiti.	

Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Matematikë.	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësit: Gjithëpërfshirëse
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>1- Parashikimi: Mësuesi mund ta zhvillojë këtë orë mësimi në një Bankë kursimi pranë shkollës ose të ftojë në klasë një punonjës Banke, që mund të jetë prindi ose i afërmi i një fëmije. Ai shpjegon rolin e Bankës dhe mënyrën se si funksionon ajo si dhe shërbimet që funksionojnë.</p> <p>2- Ndërtimi i njohurive: Nxënësit ftohen të bëhen bankierë, punonjës banke, ose klientë të rregullt në sportelet e Bankës. Ata krijojnë arkën e tyre të kursimeve. Mësuesi u mëson politikat e kursimeve ose bankierja u shpjegon si të ruajnë paratë dhe t'i përdorin për pushime etj.</p> <p>3- Përforcim: Mësuesi mund t'u organizojë një vizitë në Muzeun e Bankës së Shqipërisë.</p> <p>Vlerësimi: vlerësohen për gjuhën e përdorur, komunikimin me terma financiarë, komentet etj.</p> <p>Detyrë</p>	

Planifikim i orës mësimore 5.5 - 5.6

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qyteti ynë, një vend ku njerëzit hapin biznese të reja. (2 orë)		Situata e të nxënësve: Veprimtari praktike	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake; • bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët, në një punë në grup; • zhvillon një projekt në grup dhe propozon ide në lidhje me temën. 		<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dalloj prodhuesin, konsumatorin dhe sipërmarrësin; • hartoi një plan të thjeshtë biznesi. 	
Fjalë kyçe: Sipërmarrës, Biznes, Konsumator, Produkt, Administrator.		Burimet: Teksti, sende personale, lodra, veshje, libra, bileta etj.	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte, Matematikë.	Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësit: Gjithëpërfshirëse		
<p>Organizimi i orës së mësimi:</p> <p>1- Parashikimi: Ky mësim zhvillohet në dy orë. Në orën e parë mësuesi shpjegon si funksionon një biznes. Mund të jetë edhe prindi i një prej nxënësve të klasës, i suksesshëm në biznes, që mund t'u flasë nxënësve se si ngrihet dhe mbahet në këmbë një biznes. Ai tregon se cilët janë protagonistët e saj: sipërmarrësi, prodhuesi, konsumatori. Baza ekonomike për biznes mund të shfrytëzojë hua bankare me interesa të leverdishme.</p>			

Në orën e dytë, nxënësit ndahen në grupe dhe përcaktojnë planin për ngritjen e një biznesi. Ja disa ide në lidhje me to: *shitja e objekteve të krijuara me materiale të riciklueshme; Shitja e lodrave të përdorura me çmime të kënaqshme; shitja e ëmbëlsirave të përgatitura me ndihmën e prindërve.*

Aktivitetet sportive në Komunitet, duke shfrytëzuar terrene sportive të shkollës ose zonës së banimit. Prindërit dhe banorët do të jenë klientë, duke blerë bileta dhe produkte të përgatitura prej nxënësve. Të ardhurat do të përballojnë qiranë që nxënësit do të paguajnë për taksën e vendit, ose terrenit sportivë në shkollë.

Pjesa tjetër përdoret për mjetet/orenditë e klasës (glob, harta, topa futbollit, rrjetë volejbollit, magnetofon, pse jo dhe video projektor).

Planifikim i orës mësimore 5.7

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Edukim për shoqërinë	Shkalla: II	Klasa: III
Tema mësimore: Qyteti ynë një vend ku njerëzit komunikojnë.		Situata e të nxënët: Lajmi shpërndahet.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> përdor mediat digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar; menaxhon emocionet, mendimet, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve për kryerjen e një aktiviteti në shkollë apo terren. 		Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> listoi forma komunikimi; përgatit lajme dhe menaxhon shpërndarjen e tyre. 	
Fjalë kyçe: Lajme, komunikim, media, teknologji, gazeta, radio lokale.		Burimet: Lajme, burime, media, fletëpalosje, internet.	
Lidhja me fusha të tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhë dhe komunikim, Arte		Metodologjia dhe veprimtaria e nxënësit: Gjithëpërfshirëse	

Organizimi i orës së mësimt:

1- Parashikimi: Mësuesi njeh nxënësit me mënyrat e ndryshme të komunikimit të banorëve në një qytet, rolin e saj në mbarëvajtjen e jetës së qytetit. Ai jep informacion për dhënien e lajmit që nga lashtësia e deri me sot (mënyra e evolimit komunikativ).

2- Ndërtimi i njohurive: Mësuesi fton nxënësit të sjellin përvoja personale të marrjes së lajmeve të ndryshme. Ai u jep informacion për rolin kyç të medias së shkruar e vizive, në dhënien e një lajmi. U mëson nxënësve si mund të ushtrojnë profesionin e gazetarit në shkollë, komunitet. Nxënësit ftohen të përdorin mënyra të dhënies së lajmeve në komunitetin e tyre.

Shembull: Në shkollë është ftuar një aktor, shkrimtar, sportist, këngëtar ose një figurë publike, ish-nxënës i shkollës.

Ndahen nxënësit në grupe dhe përgatisin lajmin.

Përgatiten fletëpalosje, shfrytëzohet gazeta e shkollës, qendra e zërit në shkollë (megafoni), telefonat e prindërve.

Lajmi mund të përgatitet për organizime, aktivitetesh në komunitet. Ja disa tema që mund t'i përdorë mësuesi: “Dita e qytetit të pastër”, “Qyteti i gjelbër”, “Dita e ndihmës ndaj të moshuarve” etj. Në këto aktivitete, nxënësit mund të përdorin edhe fletushka të përgatitura në PC me ndihmën e prindërve. Shfrytëzohet gazeta lokale për dhënien e lajmit.

3- Përforcimi: Në përfundim të kapitullit, nxënësit dhe mësuesit në bashkëpunim mund të krijojnë, në ambientet e shkollës, stenda kushtuar tematikës së përzgjedhur për aktivitetin. Shembull: “Dita e qytetit të pastër”, “Qyteti i gjelbër”, “Dita e ndihmës ndaj të moshuarve” etj.

